



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Telekomit të Kosovës sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Telekomit të Kosovës sh.a (TK sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Telekomit të Kosovës sh.a deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

B1 (a) Gjykata e Apelit me aktvendimin e datës 07.02.2022 kishte aprovuar ankesën e Telekomit të Kosovës, duke anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, më të cilin ishte shpallur i ekzekutueshëm vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (GJNA) i datës 09.12.2016 që obligoi Telekomin e Kosovës Sh.a të paguaj dëmshpërblim ndaj Dardafon vlerën prej 31,178,920€. Përveç tjerash, Telekom kishte kërkuar edhe caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullimin e përmbarimit, mirëpo gjykata nuk kishte vendosur lidhur me këtë kërkesë duke deklaruar që i mbetet gjykatës së shkallës së parë të vendos lidhur propozimin në fjalë. Gjykata e shkallës së parë deri në kohen sa ne ishim në proces të auditimit, akoma nuk kishte caktuar seancën e shqyrtimit në rigjykim. Deri në fund të vitit 2021 borxhi i mbetur ndaj Dardafon në bazë të vendimit të GJNA ishte 8,808,128€.

(b) Dardafon, në vitin 2019, kishte iniciuar një arbitrazh të dytë ndaj ndërmarrjes. Vlera e kërkesë padisë sipas Dardafon ishte rreth 50,000,000€ dhe i referohet mos vazhdimi të Marrëveshjes Bazë për Operatorin e Rrjetit Mobil Virtual (ORMV) dhe mos ofrimit të disa shërbimeve gjatë periudhës së Marrëveshjes. Në bazë të kësaj, Gjykata e Arbitrazhit me datë 18.02.2022 kishte vendosur në favor të Dardafon dhe borxhi që duhet të paguaj Telekom i Kosovës sipas këtij vendimi është 13,466,089€ përfshirë kamatat ndëshkuese. Kjo rëndon edhe më tej gjendjen e vështirë financiare të Ndërmarrjes, ku rrjedha neto e parasë vazhdon të jetë negative edhe për vitin 2022.

(c) Obligimet ndaj ATK-së në fund të vitit kanë arritur në shumën 12,727,748€.

(d) Aktiviteti kryesor i biznesit të ndërmarrjes është i mbështetur në teknologji informative. Gjendja e platformave dhe sistemeve telekomunikuese vazhdon të jetë e rëndë. Për shumicën e sistemeve nuk ka kontrata aktive të mirëmbajtjes/përkrahjes teknike nga prodhuesi. Sipas vlerësimeve të zyrtarëve të ndërmarrjes, projektet investive të domosdoshme kapin shumën 19 milionë euro.

(e) Ndërmarrja ka pësuar humbje për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021 në vlerë prej 10,829,000€. (2020: 18,727,000€. Ndërmarrja e ka vazhduar trendin e operimit me humbje për shtatë (7) vite me radhë dhe humbjet e akumuluar deri me 31 dhjetor 2021 janë në vlerë 76,264,000€. Përveç kësaj, me 31 dhjetor 2021 detyrimet rrjedhëse tejkalojnë pasuritë aktuale për shumën prej 52,605,000€ (2020: 66,233,000€).

(f) Treguesit kyç financiar të përllogaritur në shifrat e pasqyrave financiare të vitit 2021, janë negativ.

Të gjitha çështjet e listuara më lart janë tregues se ndërmarrja ka pasiguri të shumta me parimin e vijimësisë, respektivisht nuk është e sigurt nëse mund t'i përballoj këto obligime dhe t'i vazhdoj aktivitetet e saj operative.

B2 Detyrimet Kontingjente të shpalosura në pasqyra ishin mbivlerësuar për 63,588,796€. Po ashtu, shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion, për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente. Në vitin 2018, një OE kishte iniciuar një arbitrazh kundër ndërmarrjes. Vlera e kërkesë padisë sipas OE është 10,377,264€ dhe i referohet kompensimit të dëmit-fitimit të humbur për shkak të shkëputjes së njëanshme të aneksit 5 të marrëveshjes komerciale për zhvillimin e platformës IPTV dhe IPTV-OTT.

C1 Donacionet nga Qeveria të prezantuara në kuadër të të hyrave të shtyra në vlerë prej 2,350,526€ ishin nënvlerësuar për vlerën 1,200,025€. Kjo për faktin se zhvlerësimi i grantit nuk ishte bërë në harmoni me jetëgjatësinë e përcaktuar të pasurisë për të cilën ishte destinuar. Kjo ka ndikuar edhe në mbivlerësimin e të hyrave tjera në pasqyrën e të ardhurave.

- A1 Regjistrimi i vlerës totale të faturës për qira si shpenzime të parapaguara edhe pse ndërmarrja kishte nënshkruar marrëveshje me qiradhënësin për pagesë me këste mujore, ka ndikuar në keq klasifikim të zërit shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera afatshkurtra në vlerë 307,520€, e po ashtu në keq klasifikim të obligimeve në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë 362,873€.
- B3 Ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes kontabël me të dhënat e kreditorëve. Si rezultat i kësaj, në një (1) rast shuma e borxhit e konfirmuar nëpërmjet konfirmimeve të jashtme ishte më e ulët për 6,830€ se shuma e borxhit në regjistrat kontabël, si dhe katër (4) raste shuma e konfirmuar ishte më e lartë për 355,125€ nga ajo e regjistrave kontabël. Përveç kësaj, në mungesë të konfirmimit nga ana e tyre, për njëmbëdhjetë (11) furnitorë nuk kemi arritur të verifikojmë gjendjen kontabël të detyrimeve në vlerë prej 916,224€.
- A2 Zëri e drejta e shfrytëzimit të pasurive i prezantuar në bilancin e gjendjes në vlerë 7,673,312€ nuk prezanton gjendjen e saktë. Në kuadër të këtij zëri nuk ishte përfshirë vlera 375,930€ për dy kontrata të marrjes me qira të objekteve të cilat ndërmarrja i kishte nënshkruar në vitin 2021. Si rrjedhojë, edhe zërat zhvlerësimi dhe interesi për të drejtën e shfrytëzimit të pasurive të prezantuar në pasqyrën e të ardhurave ishin nënvlerësuar për 118,650€.
- A3 Provizionet e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shpenzimet për provizionet kontingjente në pasqyrën e të ardhurave ishin mbivlerësuar për 200,000€, si rezultat i përfshirjes të një rasti të mbyllur në favor të ndërmarrjes nga gjykata përkatëse.
- A4 Ndërmarrja për arkëtimet në avans me vlerë 362,431€ nga konsumatorët e saj, nuk i kishte njohur si detyrime ndaj konsumatorëve apo detyrime afatshkurtëra, por për këtë shumë kishte zvogëluar totalin e llogarive të arkëtueshme.
- A5 Zëri kontabël “Investimet në vijim”, i prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 277,152€, nuk e prezanton saktë gjendjen e tij. Në kuadër të kësaj shume, është përfshirë vlera prej 131,539€ e projektit “Shërbime të Instalimit të pajisjeve Wi-Fi Offload”, që sipas konfirmimeve zyrtare këto pajisje janë në funksion dhe kompanisë i krijojnë përfitime ekonomike.
- A6 Ndërmarrja kishte bërë thyerje të obligimeve në vitin 2020 me Radio Televizionin e Kosovës. Kjo ka ndikuar në nënvlerësimin e salldove fillestare të vitit 2021 të llogarive të arkëtueshme në vlerë 186,033€.
- A7 Për shkak të vështirësive në identifikimin e konsumatorëve me rastin e pagesave të borxheve, arkëtimet në shumën prej 137,658€, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar në sistemin e të hyrave si “Mjete të pa alokuara”.
- A8 Gjatë vitit 2021 ndërmarrja kishte bërë mbyllje të zërit investime në vijim në vlerë 53,913€ të cilat i takojnë periudhave të më hershme që nga viti 2017. Kjo vlerë nuk ishte kapitalizuar si pasuri, por ishte njohur si shpenzim i periudhës.
- A9 Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se për një pjesë të madhe të shpenzimeve të zhvlerësimit për 2021 por edhe të viteve të mëhershme janë aplikuar normat të zhvlerësimit jo në pajtueshmëri me bazën ligjore. Si rrjedhojë, ne nuk kemi arritur të konfirmojmë vlerësimin e drejtë dhe prezantimin e saktë të shpenzimeve të zhvlerësimit dhe vlerën neto të pasurive.
- B4 Për shkak të çështjeve të ngritura në lidhje me të hyrat, shpenzimet dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

- B5 Bazuar në çështjet e ngritura për zërat kontabël si, të arkëtueshmet, pagueshmet, parapagimet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteteve operative të rrjedhës së parasë, rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në kapitullin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Telekomit të Kosovës sh.a nuk ishin në përputhje me:

Baza për konkluzion

- A10 Ndërmarrja nuk ka finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2021, deri me datën 22.04.2022, kur edhe është bërë aprovimi i tyre nga Bordi Drejtues, edhe përkundër kërkesave ligjore që të njëjtat të jenë të nënshkruara dhe aprovuara me datën 15 mars 2022.
- C2 Si rezultat i ndryshimeve me aneks të kushteve të kontratës bazë në disfavor të kompanisë, për vitin 2021 kompania kishte paguar 155,156€ shpenzime të provizionit ndaj Partnerit afarist.
- C3 Ndërmarrja, përveç pagesës së provizionit dhe bonuseve, kompenson partnerin afarist edhe me një tarifë fikse prej 1.2% të shitjeve mujore për shpenzimet e marketingut që partneri i ka kryer emër të kompanisë, por nuk merr asnjë raport kthyes/pranimi për këto shpenzime. Kostoja e tyre për vitin 2021 ishte 49,845€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Telekomit të Kosovës sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Telekomit të Kosovës sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Telekomit të Kosovës sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Telekomit të Kosovës sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Telekomit të Kosovës sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Telekomit të Kosovës sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 29 rekomandime, prej tyre 17 janë rekomandime të reja, 9 të përsëritura dhe 3 pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Përdorimi i papërshtatshëm i Bazës Kontabël të Vijimësisë

Gjetja

Sipas SNK 1, kur përgatit pasqyrat financiare, menaxhmenti duhet të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi bazën e vijimësisë më përjashtim të rasteve kur menaxhmenti synon të likuidojë njësinë ekonomike, ose të ndërpresë veprimtarinë e saj, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare ishte e papërshtatshme për rrethanat. Bazuar në evidencën e auditimit, kemi arritur në përfundim se ekzistojnë pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte të cilat, veçmas apo së bashku, mund të hedhin dyshime serioze mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi si:

(a) Në vitin 2009, Telekom i Kosovës Sh.a kishte lidhur marrëveshje partneriteti/mbështetje me Operatorin e Rrjetit Mobil Virtual (ORMV) Dardafon.net I.I.C.

Në vitin 2016 Dardafon.net kishte ngritur padi kundër Telekomit të Kosovës Sh.a në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit (GJNA), për mosrespektim të marrëveshjes bazë. Në vendimin përfundimtar (ICC Case No 20990/MHM, të datës 09.12.2016) GJNA ndër të tjera obligoi Telekomin e Kosovës të paguajë dëmshpërblim ndaj Dardafon në vlerë prej 31,178,920€.

Më pas, Dardafon dhe Telekom i Kosovës kanë lidhur Marrëveshjen për Ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit me datën 24.05.2017 sipas së cilës Telekom i Kosovës të heqë dorë nga inkasimi i 27% të hyrave nga Dardafon deri me 31.12.2023, ndërsa Dardafon kishte tërhequr propozimin për ekzekutim të datës 07.03.2017.

Me datë 26.04.2018 Dardafon përmes një shkrese zyrtare ka dërguar njoftim në Telekom për shkëputje të Marrëveshjes për Ekzekutim të

Vendimit të Arbitrazhit. Më pas, Dardafon kishte iniciuar procedurën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, të cilin kjo gjykatë e kishte njohur/shpallur të ekzekutueshëm me datën 11.02.2019.

Me datë 15.07.2019, Përmbaruesi privat i angazhuar nga Dardafon, kishte lëshuar Urdhërin për përmbarim, por ndaj këtij urdhëri me datën 18.07.2019, Telekomit kishte parashtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Me datë 17.11.2020 Telekomit dhe Dardafon kishin lidhur marrëveshje për pagesën e borxhit si rezultat i procedurës përmbarimore të datës 15.07.2019 për përmbarimin e propozuar nga kompania "Dardafon" lidhur me vendimin përfundimtar të Arbitrazhit. Borxhi i mbetur sipas kësaj marrëveshje ishte 17,281,142€ i cili do të paguhet në 24 kështe mujore. Kësti mujor që duhej të paguhet ishte 720,048€, shtuar kësaj edhe 7% kamatë vjetore dhe shpenzimet e përmbarimit.

Megjithatë, në bazë të kërkesës së Telekomit lidhur me kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, (CML Nr.12/2020, të datës 20.01.2021), Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin e datës 17.12.2021 (KI 84/21), ka shpallë të pavlefshëm aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe po ashtu dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, (Ac.nr.3610/20, të dt.20.10.2020), duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Në rigjykim, Gjykata e Apelit me aktvendimin e datës 07.02.2022 kishte aprovuar ankesën e Telekomit të Kosovës, duke anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, (PPP.nr.1486/19,) dhe duke e kthyer rastin në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Vlen të ceket se Telekomit pranë Gjykatës së Apelit kishte kërkuar edhe caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullimin e përmbarimit, mirëpo gjykata nuk kishte vendosur lidhur me këtë kërkesë duke deklaruar që i mbetet gjykatës së shkallës së parë që të vendos lidhur propozimin në fjalë. Gjykata e shkallës së parë deri në kohën sa ne ishim në proces të auditimit, akoma nuk kishte caktuar seancën e shqyrtimit për rigjykim të rastit. Deri në fund të vitit 2021 borxhi i mbetur lidhur me këtë marrëveshje ishte 8,808,128€.

(b) Dardafon, në vitin 2019, kishte iniciuar një arbitrazh të dytë ndaj ndërmarrjes. Vlera e kërkesë padisë sipas Dardafon është rreth 50,000,000€ dhe i referohet mos vazhdimi të Marrëveshjes Bazë për MVNO dhe mos ofrimit të disa shërbimeve gjatë periudhës së Marrëveshjes bazë. Në bazë të kësaj, Gjykata e Arbitrazhit me datë 18.02.2022 kishte vendosur në favor të Dardafon dhe borxhi që duhet të paguaj Telekomit i Kosovës sipas këtij vendimi është 13,466,089€ përfshirë kamatat ndëshkuese.

(c) Kësti i lartë mujor të cilin Telekomit gjatë vitit 2021 ishte i obliguar t'ia paguaj Dardafonit, ka pamundësuar pagesën e Obligimeve ndaj ATK dhe Trustit Pensional. Si rezultat, obligimi ndaj ATK-së është rritur në vazhdimësi që së bashku me obligimin e bartur para vitit 2021 ka arritur vlerën prej 12,727,748€. Kësti mujor që duhej të paguhet ishte 170,000€ në bazë të marrëveshjes me ATK-në. Vlen të ceket se me vendimin nr 01/53 e datës 31.12.2021 Qeveria e Republikës së Kosovës kishte aprovuar kërkesën e Telekomit për mbështetje financiare në vlerë 10,000,000€ për mbulimin e obligimeve që kishte ndaj ARKEP. Nëse nuk do të ishte

mbështetja e Qeverisë, Telekomit rrezikonte Licencën e operimit - tërheqjen e të drejtës për shfrytëzim të resurseve frekuencore në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz.

(d) Më tej, sipas raportit nga Departamenti Teknik të datës 18.05.2022, gjendja e platformave dhe sistemeve telekomunikuese vazhdon të jetë e rëndë. Kjo gjendje për disa platforma është qysh para vitit 2010 (për sistemet transmetuese telefonia fikse) ndërsa në rrjetin mobil që nga viti 2016 kur janë bërë instalimet e fundit në rrjetë. Pastaj, kjo gjendje në mënyrë progresive ka ardhur duke u keqësuar si rezultat i daljes nga garancioni i pajisjeve, konsumi i pjesëve rezervë në stok si dhe amortizimi i pajisjeve. Për shumicën e platformave dhe sistemeve të cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve telekomunikuese, mirëmbajtja kryhet vetëm nga stafi teknik i ndërmarrjes. Për shumicën e sistemeve (rrjeti fiks, mobil, IPTV dhe ISP) nuk ka kontrata aktive të mirëmbajtjes/përkrahjes teknike nga prodhuesi. Ky raport ka renditur një serë rreziqesh të mundshme që do të ndikonin në ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të shërbimeve ndaj konsumatorëve, pamundësinë e neutralizimit të problemit dhe kohëzgjatjen e zgjidhjes së problemit dhe pamundësia e riparimit të pajisjeve me defekte në të gjitha pjesët e rrjetit si rezultat i gjendjes aktuale dhe mungesës së investimeve dhe kontratave të mirëmbajtjes. Sipas vlerësimeve të zyrtarëve të Kompanisë projektet investive të domosdoshme kapin shumë prej 19 milionë euro.

Për shkak të gjendjes së rënduar financiare me të cilën përballlet Telekom, Qeveria e Kosovës ka ndarë shumë 40 milionë euro për dy ndërmarrje publike, njëra prej të cilave është Telekom i Kosovës. Megjithatë nuk na është prezantuar ndonjë dokument formal (vendim ose marrëveshjeje) lidhur me shumë që do t'i ndahet Telekomit. Bazuar në këtë, ndërmarrja në vitin 2021 kishte filluar procedurat e prokurimit për projektin Migrimi në Kodin Telefonik të RKS dhe Modernizimi i Rrjetit Mobil në vlerë të parashikuar 12,984,118€ projekt i cili do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e shërbimeve dhe rritjen e të hyrave, ndërsa implementimi i kodit shtetëror do i kursente ndërmarrjes rreth 1.5 milion euro në vit. Ndërsa, vlen të theksohet se me datë 25.05.2022 Qeveria e Kosovës ka aprovuar në parim kërkesën për huamarrje për financimin e pakove dalëse për shkëputjeje vullnetare të marrëdhënies së punës për punëtorët e Telekomit në vlerë 7,775,586€. Sipas kërkesës, kthimi i huamarrjes do realizohet nga viti 2027.

(e) Kompania ka pësuar humbje për vitin raportues në vlerë prej 10,829,000€ (2020: 18,727,000€). Kompania e ka vazhduar trendin e operimit me humbje për shtatë (7) vite me radhë dhe humbjet e akumuluar deri me 31 dhjetor 2021 janë 76,264,000€. Përveç kësaj me 31 dhjetor 2021 detyrimet rrjedhëse tejkalojnë pasuritë aktuale për shumë prej 52,605,000€ (2020: 66,233,000€). Ndërsa, me datë 31.12.2021 Qeveria e Kosovës kishte vendosur për shlyerjen e dividendës së deklaruar prej 15,000,000€.

(f) Treguesit kyç financiar të përlogaritur në shifrat e pasqyrave financiare të vitit 2021, janë negativ:

Likuiditeti i rrjedhës ishte 0,25 ndërsa koeficienti i dëshirueshëm/i pranueshëm varion nga 1,5 deri në 2. Likuiditeti i rrjedhës më i vogël se 1 është tregues që Kompania mund të ketë probleme serioze në përmbushjen e detyrimeve të sajë afatshkurta.

Likuiditeti i Shpejtë (Testi Acid) është 0.21. Testi acid më i vogël se 1 tregon po ashtu që kompania mund të ketë probleme serioze në përmbushjen e detyrimeve të saja afatshkurta.

Neto kapitali punues është në vlerë negative -0,86 (apo në vlerë financiare - 52,605,000€). Kapitali i punës negativ është kur detyrimet rrjedhëse të kompanisë tejkalojnë pasuritë e saj aktuale. Raporti optimal i pranueshëm është midis 1.2 dhe 2.

Raporti i Borxhit ishte 1.27, pjesëmarrja e detyrimeve në pasuri është mbi 100%. Raporti më i madh se 0.5 apo 50%, nënkupton që shumica e asetëve të kompanisë financohen përmes borxhit. Sa më i lartë të jetë ky raport aq më i lartë është rreziku i funksionimit/operimit të kompanisë. Përveç kësaj, raporti i borxhit të lartë ndaj aktiveve mund të tregojë një kapacitet të ulët të kompanisë për huamarrje, e cila nga ana tjetër do të ulë fleksibilitetin financiar të kompanisë.

Të gjitha këto që u përmendën më lartë janë pasojë e menaxhimit të dobët për shumë vite dhe mos aplikimit të drejtë dhe të plotë të kërkesave të SNK1 me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare. Menaxhmenti e kishte konsideruar si të mjaftueshëm vetëm faktin e shpalosjes së pasigurive materiale dhe kishte vlerësuar se nuk ekziston rrezik real që e ndikon parimin e vijimësisë gjatë vitit 2022.

Ndikimi

Prezantimi i pasqyrave financiare në një bazë jo të përshtatshme për rrethanat, shpie në prezantim të pasaktë të informacionit financiar ndaj përdoruesve të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se është bërë një analizë e detajuar për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikim të Opinionit dhe të merren veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar. Pasqyrat financiare të Kompanisë duhet të përgatiten në një bazë e cila është e përshtatshme dhe e bazuar në realitetin ekonomik të Kompanisë. Nënshkrimi i pasqyrave nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zytari Kryesor Financiar duhet të bëhet vetëm nëse ndaj Pasqyrave Financiare Vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollat e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit të Drejtorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Shpalosja jo e saktë dhe mos dhënia e informacioneve shpjeguese për kontigjencat

Gjetja

Sipas SNK 37-Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara, Një pasiv i kushtëzuar është: një detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga zhvillimi ose jo i një ose disa ngjarjeve të ardhshme të pasigurta jo tërësisht nën kontrollin e njësive ekonomike ose një detyrim aktual që rrjedh nga ngjarje të shkuara por që nuk është njohur sepse: nuk ka mundësi që për të shlyer detyrimet të kërkohej një dalje burimesh që përfshin përfitime ekonomike ose shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme.

Vlera 82,278,000€ e prezantuar në shënimin 25 të pasqyrave financiare - Detyrimet Kontingjente, nuk ishte e saktë. Në bazë të dëshmive të ofruara nga ndërmarrja vlera që do të duhej të shpaloset është 18,689,204€. Pra, vlera e prezantuar ishte e mbivlerësuar për 63,588,796€.

Po ashtu, shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion, për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente. Në vitin 2018, një OE kishte iniciuar një arbitrazh ndaj ndërmarrjes. Vlera e kërkesë padisë sipas OE ishte 10,377,264€ dhe i referohet kompenzimit të dëmit-fitimit të humbur për shkak të shkëputjes së njëanshme të aneksit 5 të marrëveshjes komerciale për zhvillimin e platformës IPTV dhe IPTV-OTT.

Shkak i shpalosjes jo të saktë të detyrimeve kontingjente ishte mos përditësimi i regjistrimit të kontingjencave me vendimet finale të gjykatave përkatëse. Ndërsa, Menaxhmenti e kishte konsideruar si informacion të ndjeshëm shpalosjen e padisë në pasqyrat financiare.

Ndikimi

Mos dhënia e informacioneve shpjeguese të plota ka ndikim në besueshmërinë dhe kuptueshmërinë e pasqyrave financiare nga përdoruesit.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente dhe pasuri kontingjente, të jepen informacione shpjeguese për to në shpalosjet dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Prezantimi jo i saktë i të hyrave të shtyera nga grantet

Gjetja

Njëra nga metodat e paraqitjes së granteve për aktive në kontabilitet sipas SNK 20, është njohja e grantit si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar e cila pastaj në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivitetit njihet si e ardhur në pasqyrën e të ardhurave për secilën periudhë.

Donacionet nga qeveria të prezantuara në kuadër të zërit të hyrat e shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej 2,350,526€, nuk prezantojnë saktë gjendjen e tyre. Në bazë të vendimit Nr. 01/53 të Qeverisë, me datë 31.12.2021 ndërmarrja kishte lidhur marrëveshje me Ministrin e Ekonomisë për mbështetje financiare në mbulimin e obligimeve financiare ndaj Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Postare Elektronike në vlerë 10,000,000€. Përveç shpenzimeve tjera në kuadër të obligimeve të akumuluar, me marrëveshje ishte paraparë edhe mbulimi i obligimit në vlerë 3,445,884€ për licencën e vazhdimit të drejtës së shfrytëzimit të resurseve frekuencore. Kjo licencë ishte regjistruar në regjistrin e pasurive në vitin 2019 në vlerë 12,579,418€ me jetëgjatësi të shfrytëzimit 20 vite.

Ndërmarrja kishte njohur të hyra të shtyra nga donacionet vlerën prej 1,886,912€. Testimet tona tregojnë se vlera e prezantuar ishte e nënvlerësuar për 1,200,025€, dhe për të njëjtën vlerë ishin mbivlerësuar të hyrat tjera në pasqyrën e të ardhurave.

Kjo kishte ndodhur pasi zhvlerësimi i grantit ishte kalkuluar për gjashtë (6) vite dhe jo për njëzetë (20) sa do të shfrytëzohet licenca.

Ndikimi

Kalkulimi i gabuar i vlerës se të hyrave të shtyra nga donacionet e Qeverisë ka shkaktuar prezantim jo të saktë të hyrave të shtyra, dhe të hyrave tjera në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe të bëhen korrigjimet adekuate në kontabilitet ashtu që të hyrat nga granti të njihen dhe detyrimet ndaj grantit të zvogëlohen në periudhën e saktë dhe në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Prezantim jo i drejtë i parapagimeve

Gjetja

Parapagimet janë pagesa të bëra gjatë një periudhe të kontabilitetit, por të cilat nuk duhet t'i ngarkohen fitimit deri në një periudhë të mëvonshme, për arsye se ato kanë të bëjnë me periudhën e mëvonshme në fjalë. Këto klasifikohen si pasuri, sepse ndërmarrja ka kontrollin mbi to dhe pret të marrë prej tyre përfitime nga data e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Me datë 23.01.2017 ndërmarrja kishte nënshkruar një aneks kontratë për marrje me qira të një objekti për të cilin parashihej që për periudhën qershor 2021 deri në maj 2023 (24 muaj) të paguhet në avans vlera bruto prej 544,310€. Megjithatë, për shkak të pamundësisë financiare të pagesës në avans, ndërmarrja kishte nënshkruar marrëveshje me qiradhënësin në bazë të së cilës ishin dakorduar që pagesa e qirasë të bëhet në baza mujore në vlerë prej 22,679€ për çdo muaj si parapagim.

Edhe pse ndërmarrja kishte arritur marrëveshje për pagesë me këste të obligimeve, në regjistra kontabël ndërmarrja kishte regjistruar vlerën totale të marrëveshjes si shpenzime të shtyra në kuadër të parapagimeve dhe njëkohësisht edhe obligim ndaj qiradhënësit.

Si rrjedhojë, saldo në fund e parapagimeve për të njëjtin qiramarrës do të duhej të ishte 19,220€ e parapaguar për muajin janar 2022, ndërsa në regjistra figuron vlera 326,740€. Po ashtu, kjo ka ndikuar edhe në keqklasifikimin e obligimeve për 362,873€ e cila vlerë është obligim i viteve në vijim, përderisa nuk kishte obligime të papaguara për vitin 2021.

Kjo kishte ndodhur për shkak se, qiradhënësi kishte faturuar vlerën totale prej 544,310€ për dy (2) vite dhe jo sipas kushteve të marrëveshjes së nënshkruar për pagesën me këste të obligimeve.

Ndikimi

Regjistrimet e tilla, kanë ndikuar në keqklasifikim të zërit shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshmet tjera afatshkurtra, dhe po ashtu në keqklasifikim të obligimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në datën e pasqyrave financiare të prezantohen vetëm parapagimet që lindin nga veprimet rregulluese për to, si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese për parapagime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme tregtare

Gjetja

Sipas Ligji Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12 Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve, pika 1, përcakton, që shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave ligjore të këtij ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Gjatë vitit 2021, ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjes kontabël me të dhënat e kreditorëve. Si rezultat i kësaj, në një (1) rast shuma e borxhit e konfirmuar nëpërmjet konfirmimeve të jashtme ishte më e ulët për 6,830€ se shuma e borxhit në regjistrat kontabël si dhe katër (4) raste shuma e konfirmuar ishte më e lartë për 355,125€ nga ajo e regjistrave kontabël. Përveç kësaj, në mungesë të konfirmimit nga ana e tyre, për njëmbëdhjetë (11) furnitorë nuk kemi arritur të verifikojmë përputhshmërinë e gjendjes së detyrimeve në vlerë prej 916,224€.

Këto diferenca kishin ndodhur pasi që ndërmarrja nuk kishte kryer harmonizimet periodike me furnitorët.

Ndikimi

Diferencat në gjendjen e llogarive në mes debitorit dhe kreditorit pas konfirmimeve, shkaktojnë dyshime në gjendjen e vërtetë të detyrimeve të ndërmarrjes. Për pasojë, edhe pasqyrat financiare mund të mos e reflektojnë gjendjen e saktë të llogarive.

Rekomandimi B3

Bordit i Drejtorëve të sigurojë, se regjistri i obligimeve rishikohet periodikisht dhe bëhet harmonizimi i kartelave të llogarive në mënyrë sistematike në mes ndërmarrjes dhe furnitorëve. Përveç kësaj, të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar gabimet e identifikuara në shënimet kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Prezantim i pasaktë i të drejtave të shfrytëzimit të pasurive

Gjetja

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16-Qiratë, vendos parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Objektivi është që të sigurohet se qiramarrësit dhe qiradhënësit japin informacionin përkatës, në mënyrë që këto transaksione të paraqiten në mënyrë të besueshme. Ky informacion u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare që të vlerësojnë efektin që qiratë kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë Standard në mënyrë të qëndrueshme (uniforme) për kontrata me karakteristika të ngjashme dhe në rrethana të ngjashme. Qiramarrësi do të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar ose të japë informacion shpjegues në shënimet për aktivet me të drejtë përdorimi veçmas nga aktivet e tjera dhe detyrimet e qirasë veçmas nga detyrimet e tjera. Në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, qiramarrësi do të paraqesë shpenzimin e interesit mbi detyrimin e qirasë veçmas nga shpenzimi i amortizimit të aktivit me të drejtë përdorimi. Në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, qiramarrësi do të klasifikojë pagesat në mjete monetare për pjesën kryesore të detyrimit të qirasë brenda aktiviteteve financiare dhe pagesat në mjete monetare për pjesën e interesit të detyrimit të qirasë.

Zëri e drejta e shfrytëzimit të pasurive i prezantuar në bilancin e gjendjes në vlerë 7,673,312€ nuk prezanton gjendjen e saktë. Në kuadër të këtij zëri nuk ishte përfshirë vlera 375,930€ për dy kontrata të marrjes me qira të objekteve të cilat ndërmarrja i kishte nënshkruar në vitin 2021.

Përveç kësaj, zërat zhvlerësimi dhe interesi për të drejtën e shfrytëzimit të pasurive të prezantuar në pasqyrën e të ardhurave në vlerë totale 5,127,313€ nuk janë të saktë pasi që nuk janë përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit dhe të interesit në vlerë 118,650€ për këto dy kontrata të qiramarrjes.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, mos përfshirja e të gjitha kontratave ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të informacioneve në mes të departamenteve përkatëse.

Ndikimi

Mos përfshirja e vlerave të të gjitha kontratave të nënshkruara për qiramarrje që plotësojnë kriterin sipas standardit, ka ndikuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive dhe njëkohësisht edhe nënvlerësim të vlerës së detyrimeve. Përveç kësaj, kjo ka ndikuar që edhe shpenzimet e zhvlerësimit dhe interesit për të drejtat e shfrytëzimit të pasurive në pasqyrën e të ardhurave të jenë të nënvlerësuara.

Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve të siguroj që të forcohen mekanizmat e kontrollit të cilat mundësojnë që vlerat e kontratave të nënshkruara për qiramarrje të përfshihen në regjistrat përkatës në mënyrë që vlerat e prezantuara në pasqyra financiare të jenë të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Prezantim i pasaktë i provizioneve

Gjetja

SNK 37-Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara në nenin 14 parasheh që, provizionet duhet të njihet nëse njëësia ekonomike ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) që është rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, ka mundësi që për shlyerjen e detyrimit të kërkohej një dalje burimesh që përfshijnë përfitime ekonomike dhe mund të bëhet një çmuarje e besueshme për shumën e detyrimit.

Provizionet e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar ishin mbivlerësuar për 200,000€. Kjo për faktin se në listën e provizioneve ishte përfshirë edhe një kontest gjyqësor me një OE për të cilën Gjykata e Apelit me datë 17.11.2021 kishte dhënë vendim përfundimtar në favor të Telekomit. Për të njëjtën vlerë janë mbivlerësuar edhe shpenzimet për obligimet kontingjente në pasqyrën e të ardhurave.

Mos prezantimi i saktë i provizioneve ka ndodhur për shkak të mungesës së këmbimit të informacioneve në mes të departamenteve, lidhur me statusin e lëndëve gjyqësore.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i provizioneve sipas kërkesave të standardit rezulton me paqartësi në gjendjen e llogarive dhe prezantim jo të drejtë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve të siguroj krijimin e procedurave adekuate që do të mundësonin që në baza vjetore të bëhet vlerësimi i provizioneve në mënyrë që prezantimi i llogarive të jetë sa më korrekt.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Prezantimi i pasaktë i detyrimeve afatshkurta**Gjetja**

Sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Kur përdoret kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avans, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbime në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej ndërmarrjes.

Arkëtimet në avans nga konsumatorët me vlerë 362,431€ që kishin parapaguar për shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile, ndërmarrja nuk i ka njohur si detyrime afatshkurta, por për këtë shumë kishte zvogëluar totalin e llogarive të arkëtueshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i parapagimeve të inkasuara ka ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve afatshkurta. Këto diferenca kanë ndikuar edhe në mos prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se vlera e detyrimeve të njihet dhe prezantohet saktë në PFV, si dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Prezantimi i pasaktë i investimeve në vijim**Gjetja**

Sipas SNK 16 pika 55, amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Zëri kontabël "Investimet në vijim", i prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën 277,152€, nuk e prezanton gjendjen e tij të saktë. Në kuadër të kësaj shume, është përfshirë vlera prej 131,539€ e projektit "Shërbime të Instalimit të pajisjeve Wi-Fi Offload", që sipas konfirmimeve zyrtare këto pajisje janë në funksion dhe kompanisë i krijojnë përfitime ekonomike.

Shkak i mos bartjes së këtyre investimeve në pasuri, sipas zyrtarëve të departamentit të financave ishte mungesa e një raporti të pranimi teknik për këto pajisje.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive të cilat plotësojnë kushtin që të njihen si pasuri në përdorim ka rezultuar në mbivlerësimin e vlerës së tyre dhe nënvlerësimin e shpenzimeve të zhvlerësimit.

Rekomandimi A5 Bordi i Drejtorëve të siguroj se të gjitha aktivet e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore prezantojnë gjendjen e saktë të tyre dhe zhvlerësimi i pasurive të bëhet nga koha kur aktiviteti është i disponueshëm për përdorim sipas kërkesave të standardeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kompensimi i llogarive në mes Telekomit dhe Radio Televizionit të Kosovës

Gjetja Sipas SNK 1, Kompensimi pika 32. Aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk duhet të kompensohen me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një Standard ose një Interpretim, dhe pika 33. Është e rëndësishme që aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të raportohen veçmas. Kompensimi në pasqyrën e të ardhurave ose në bilanc, me përjashtim të rastit kur kompensimi reflekton thelbin e transaksionit ose një ngjarjeje tjetër, pakëson aftësinë e përdoruesve për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera që kanë ndodhur dhe për të vlerësuar flukset e ardhshme monetare të njësisë ekonomike. Matja e aktiveve për vlerën neto nga zbritjet e vlerësuara - për shembull, amortizimi moral i inventarëve dhe zbritjet për borxhet e dyshimta në llogaritë e arkëtueshme - nuk është kompensim.

Më datë 24.12.2019 ishte lidhur një marrëveshje mes Telekomit të Kosovës dhe Radio Televizionit të Kosovës për procedim të thyerjes/ kompensimit të obligimeve mes dyja palëve. Me këtë marrëveshje dy palët ishin dakorduar që: Obligimet e Telekomit të Kosovës ndaj RTK-së për pagesën e shfrytëzimit të antenave, dhe obligimet e RTK-së ndaj Telekomit të Kosovës për faturat e shpenzimeve nga shërbimet e telefonisë të thyhen apo kompensohen me obligimet të cilat i ka RTK.

Ky kompensim kishte nxjerrë një obligim neto të RTK-së ndaj Telekomit të Kosovës në vlerë prej 85,982€, me të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës reklamuese nga Telekomit i Kosovës.

Meqenëse këto transaksione nuk janë paraqitur si të plota në raportimin e PVF-ve, por është përdorur metoda e saldove neto, për këtë arsye zëri i llogarive të arkëtueshme është nënvlerësuar për shumën 186,033€ në pasqyrat financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak së zyrtarët e Telekomit nuk ishin në dijeni të faktit se këto lloj paraqitjesh të informacionit financiar nuk janë të përshtatshme për raportim financiar (pra paraqitja neto e transaksioneve).

Ndikimi Thyerja e aktiveve dhe detyrimeve ndikon në paraqitjen neto të zërave dhe paraqitjen jo të drejtë të llogarive në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Rekomandimi A6 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në të ardhmen do të merren veprime korrigjuese, në mënyrë që prezantimi i informacionit financiar të jetë i plotë dhe konform standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A7 - Mos zbritja e pagesave të konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara**Gjetja**

Sipas SNK 1, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje të besueshme të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet. Zbatimi i SNRF-ve me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë, supozohet të rezultojë në pasqyra financiare të cilat arrijnë një paraqitje të drejtë.

Arkëtimet në shumën prej 137,658€, të periudhës 2017-2021, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, por këto mjete ishin regjistruar si “Mjete të pa alokuara” në sistemin e të hyrave.

Sipas konfirmimeve zyrtare, këto arkëtime në departamentin e të hyrave nuk kanë mundur të identifikohen se cilit konsumator mund t'i ngarkohen, edhe pse çdoherë tentohet që të bëhet identifikimi i tyre në bashkëpunim me bankat apo thesarin e shtetit.

Ndikimi

Mos zbritja e pagesave të konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndikon në mos prezantim të saktë të obligimeve të konsumatorëve ndaj Kompanisë.

Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikim të klientëve, mjetet monetare të të cilëve janë regjistruar në këto llogari dhe të zbriten obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A8 - Njohja e shpenzimeve jo në periudhën përkatëse**Gjetja**

Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe duhet të përfshihen në fitim ose humbje, me përjashtim të rastit kur një Standard ose një Interpretim kërkon ndryshe.

Gjatë vitit 2021 ndërmarrja kishte bërë mbyllje të zërit investime në vijim në vlerë 53,913€ të cilat i takojnë periudhave të mëhershme që nga viti 2017. Kjo vlerë nuk ishte kapitalizuar si pasuri, por ishte njohur si shpenzim i periudhës.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, kjo kishte ndodhur në disa raste për shkak të regjistrimit të gabuar fillestar të tyre si investime në vijim, dhe gjithashtu në disa raste tjera edhe pse ishin pjesë përbërëse e projekteve kapitale, nuk janë njohur si pasuri shkak të vlerave të vogla të tyre.

Ndikimi Kategorizimi në mënyrë jo të duhur i transaksioneve ndikon në nënvlerësimin të pasurive si dhe në mbivlerësim të shpenzimeve. Përveç kësaj, njohja e ngjarjeve të cilat i përkasin periudhës paraprake, rezultojnë në mbivlerësim të shpenzimeve, respektivisht në nënvlerësim të rezultatit financiar.

Rekomandimi A8 Bordi i Drejtorëve të siguroj se regjistrimi i shpenzimeve apo pasurive duhet të njihet sipas kërkesave të standardit me plotësimin e kushtit të njohjes, në mënyrë që mos të paraqiten gabimisht në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Normat e zhvlerësimit jo në harmoni me rregullat e brendshme

Gjetja Sipas SNK 16, vlera kontabël (neto) është shuma me të cilën njihet një aktiv pasi është zbritur çdo amortizim i akumuluar dhe humbje e akumuluar nga zhvlerësimi si dhe shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahej mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa SNK 8, përcakton që efekti i ndryshimit në vlerësimin kontabël, duhet të njihet prospektivisht duke e përfshirë atë në fitimin ose humbjen në: periudhën e ndryshimit, në se ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë; ose periudhën e ndryshimit dhe periudhat e ardhshme, në se ndryshimi ndikon edhe njëherë dhe të tjerat. Njohja apo kontabilizimi prospektiv i efektit të ndryshimit në vlerësimin kontabël do të thotë që ndryshimi zbatohet për transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera nga data e ndryshimit në vlerësim. Ndryshimi në vlerësimin kontabël mund të ndikojë vetëm fitimin ose humbjen e periudhës aktuale, ose edhe periudhën aktuale edhe periudhat e ardhshme.

Procesin e përllogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit, ndërmarrja e kishte bazuar në manualin e brendshëm të politikave kontabël, ku në pjesën e tretë të këtij dokumenti përshkruhen normat e zhvlerësimit si vijon: Ndërtesat (nga data e vlerësimit) 20 vite; Zyrat postare (strukturë druri) 10 vite; Linjat e rrjetit 20 vite; Kanalet kablloviqe dhe shtyllat e antenave 20 vite; Stacionet Bazë 5 vite; Makineria dhe Pajisjet 5 deri 10 vite.

Gjatë rikalkulimeve tona kemi vërejtur se për një pjesë të madhe të shpenzimeve të zhvlerësimit për 2021, por edhe të viteve të mëhershme janë aplikuar normat të zhvlerësimit jo në pajtueshmëri me bazën ligjore. Përllogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin 2021 është shpërndarë në përputhje me jetën e përdorimit të pasurive, dhe në kuadër të së njëjtës kategori janë aplikuar norma apo përqindje të ndryshme të zhvlerësimit të bazuara në jetën e përdorimit të pasurive.

Tek Kategoritë Linjat e Rrjetit, Kanalet kablloviqe dhe shtyllat e antenave, është vërejtur që janë zbatuar përqindje të ndryshme në llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit. Disa janë si vazhdimësi nga vitet e mëparshme ku janë zbatuar afatet e ndryshme të jetëgjatësisë së pasurive (prej 5 deri 20 vite), ndërsa në vitin 2021 në këtë kategori janë regjistruar 79 pasuri në vlerë totale 295,803€ ku për zhvlerësimin e tyre janë aplikuar 4 norma të zhvlerësimit (8.33%, 10%, 20% dhe 5%). Si rrjedhojë, shpenzimet e zhvlerësimit janë përllogaritur në vlerë 20,013€ ndërsa do të duhej të ishin 8,675€ në rast se do të zbatoheshin norma 5% siç parashihet në manualin e ndërmarrjes.

Po ashtu, gjatë testimit të saldoshes së pasurive, kemi identifikuar se për disa pasuri të llojit të njëjtë dhe me kosto fillestare të njëjtë ishin aplikuar norma të ndryshme të zhvlerësimit si vijon:

- 79 Shtylla Kapriata 45m me kosto fillestare 3,001,062€ (secila nga 30,938€), në 78 raste ishte aplikuar norma 8.33% ndërsa në një rast norma 20%.
- 10 Shtylla Kapriata 30m të cilat kishin kosto fillestare 335,157€ (secila nga 33,515€), pesë (5) prej tyre ishin llogaritur me normë 8.33% ndërsa pesë (5) të tjera me normë 20%.

Për këtë kategori të pasurive është e paraparë norma 5% e zhvlerësimit apo jeta e përdorimit e 20 vite. Si rezultat i aplikimit të këtyre normave, pasuritë e regjistruara në vitet e mëhershme kishin akoma vlerë neto, ndërsa të njëjtat që ishin regjistruar në vitet e mëvonshme vlera e tyre neto ishte zero.[1]

Përveç kësaj, informatat e prezantuara në pasqyra financiare për normat e zhvlerësimit nuk ishin në harmoni me politikat e brendshme të ndërmarrjes. Si rrjedhojë, ne nuk kemi arritur të konfirmojmë vlerësimin e drejtë dhe prezantimin e saktë të shpenzimeve të zhvlerësimit dhe vlerën neto të pasurive, pikërisht për shkak të mos aplikimit të normave në bazë të manualit.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, normat e përdorura të zhvlerësimit krahasuar me normat në politikat kontabël dallojnë në raste të veçanta dhe përdoren bazuar në gjykimin profesional të ekipit që menaxhon kontratën dhe në bazë të autorizimeve vlerësohet se një investim mund të këtë jetëgjatësinë me pak se 20 vite. Sipas tyre, në shpalosjet e manualit mungojnë paragrafët/sqarimet se në këto investime mund të këtë përjashtime bazuar në gjykimet profesionale, e cila duhet të plotësohet me një aneks rregullore.

Ndikimi

Aplikimi i normave të ndryshme për pasuri të njëjta, ndikon në keq deklarim të vlerës neto të pasurive në bilancin e gjendjes dhe të shpenzimeve të zhvlerësimit në pasqyrën e të ardhurave.

Rekomandimi A9

Bordi i Drejtorëve të siguroj një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë, procesit të përlogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit, klasifikimit të pasurive në kategori përkatëse, si dhe aplikimi i normave të zhvlerësimit të jetë në pajtueshmëri të plotë me politikat dhe rregulloret e aprovuara nga Bordi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Prezantim jo i drejtë i pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet**Gjetja**

Sipas SNK 1- Paraqitja e pasqyrave financiare, një pako e pasqyrave financiare duhet të përmbaj edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet.

Çështjet e ngritura në lidhje me të hyrat, shpenzimet dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Shkak për mos prezantim të saktë të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet ishte mos prezantimi i saktë i zërave të cilat kanë ndikim edhe në këtë pasqyrë.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar, si rezultat i mos korrigjimit të gabimeve të zërave të cilat kanë ndikim në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, kanë për efekt mos prezantimin e saktë të kësaj pasqyre, por edhe të pasqyrave si tërësi.

Rekomandimi B4

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Prezantimi i pasaktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë

Gjetja

Sipas SNK 1 një pako e pasqyrave financiare duhet të përmbajë edhe një pasqyrë të rrjedhës së parasë e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha hyrjeve dhe daljeve të parasë së gatshme nga aktivitetet operative, financiare dhe investuese.

Ndërmarrja kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë, mirëpo bazuar në çështjet e ngritura për zërat kontabël si, të arkëtueshmet, pagueshmet, parapagimet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteteve operative të rrjedhës së parasë, vijnë në përfundim se rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë.

Kjo ka ardhur si rezultat i keq deklarimeve materiale në zërat e pasqyrës e pozitës financiare dhe pasqyrës së të ardhurave.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parave pamundëson prezantimin e saktë të hyrjeve dhe daljeve të parasë.

Rekomandimi B5

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se gabimet e identifikuar në PFV-të tjera të cilat reflektojnë në Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë korrigjohen para përgatitjes së pasqyrave të vitit aktual në mënyrë që shifrat krahasuese në mes të viteve të jenë të sakta dhe të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A10 - Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare

Gjetja Neni 31.3 i Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton: “Brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e shihet të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor (i) Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe (ii), sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit (eve) Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do të publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP”.

Lidhur me këtë, ndërmarrja nuk ka finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2021, deri me datën 22.04.2022, kur është bërë aprovimi i tyre nga Bordi Drejtues, edhe përkundër kërkesave ligjore që të njëjtat të jenë të nënshkruara dhe aprovuara me datë 15 mars 2022.

Sipas konfirmimeve të zyrtarëve të ndërmarrjes, vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare, ishin si rezultat i nevojës për korrigjime në pasqyra financiare për shkak të nevojës për analizimin e vendimit të fundit të arbitrazhit lidhur me Dardafonin.

Ndikimi Mos hartimi, aprovimi si dhe publikimi me kohë i pasqyrave financiare, ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe mos informimin e shfrytëzuesve të pasqyrave financiare në afatin e paraparë kohor.

Rekomandimi A10 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, aprovuar dhe publikuar në afatet e përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Ndryshimi i kushteve të kontratës në disfavor të Ndërmarrjes

Gjetja Ndërmarrja kishte lidhur kontratë për shitjen e produkteve të tyre me një OE me datë 16.03.2015 ku OE luan rolin e ndërmjetësit /distributorit të shitjes tek palët e treta. Çmimet e produkteve dhe shërbimeve kanë të përfshirë TVSH-në dhe provizioni total i shitjes ishte 9.7% e transaksionit. Pas një viti kompania kishte nënshkruar një aneks ku secilit lloj të provizionit që do të paguhet ndaj OE i është shtuar edhe 18% në emër të TVSH-së.

Ndryshimet nga kontrata bazë që kanë ndodhur pas nënshkrimit të Memorandumit të mirëkuptimit për praktikën më të mirë të llogaritjes së provizioneve, kompanisë i janë shtuar kostot e shitjes për provizionin për shitjet bazë prej 9.7% në 11.45%.

Si rezultat i këtij aneksi janë rritur edhe provizionet tjera si: provizioni për shitjet mbi 0.5 milion nga 1% në 1.18%, provizionet për shitjet mbi 1 milion për tremujor nga 1% janë bërë 1.18%, provizionet për marketing nga 1.20% në 1.42% dhe provizioni vjetor mbi 5 milionë në vit qarkullim nga 1% është bërë 1.18%. Mirëpo faturat me këto përqindje janë pranuar deri në muajin maj 2021 ndërsa nga qershori deri në dhjetor faturat janë regjistruar sipas kalkulimeve të ndërmarrjes të cilat nuk korrespondojnë me faturat e dorëzuara nga OE.

Analizat tona kanë treguar se kompania deri në muajin maj 2021 kishte paguar:

- për provizion bazë 126,526€, më shumë sesa që ishte paraparë në kontratën bazë;
- për provizionet për shitjet mbi 0.5 milion 2,286€ më shumë sesa me kontratën bazë;
- për provizionet për shitjet mbi 1 milion për TM (kuartal) 5,395€ më shumë sesa me kontratën bazë; dhe
- për provizion (bonus) vjetor mbi 5 milionë në vit 20,949€ më shumë sesa me kontratën bazë.

Kjo kishte ndodhur si shkak i interpretimit gabim të dispozitave të kontratës që kanë të bëjnë me mënyrën e llogaritjes së provizioneve dhe bonuseve nga ana e menaxhmentit të kompanisë dhe OE.

Ndikimi Ndryshimi i kushteve të kontratës ka rritur koston e provizioneve të shitjes me vlerë 155,156€.

Rekomandimi C2 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që vendimet për të ndryshuar kushtet e kontratës, të jenë të bazuara në analiza paraprake të përshtatshmërisë ekonomike, për të evituar efektet financiare negative nga vendimet e pafavorshme për ndërmarrjen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C3 - Pagesa për shpenzime të marketingut pa raporte për punën/shërbimin

Gjetja Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (LMFPP) para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, duhet të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me aktet nënligjore (rregullat KMF), ku sipas këtyre rregullave shpenzimi i parave publike i nënshtrohet procedurave të përgjithshme për procedimin e pagesave siç është fatura e pranuar dhe raporti i pranimit të mallit/shërbimit.

Ndërmarrja kishte lidhur kontratë për shitjen e produkteve të tyre me një operator ekonomik (OE) më datë 16 mars 2015. OE luan rolin e ndërmjetësit/distributorit të shitjes së produkteve tek palët e treta. Në kuadër të kësaj marrëveshje, ishte nënshkruar edhe një Aneks (Aneksi V) në lidhje me marketingun shtesë dhe marketingun promovues që OE do të zhvilloj për Telekomin dhe do të kompensohet me një komision shtesë prej 1.2% të shitjeve mujore. Mirëpo me datë 04.12.2020 ishte nënshkruar edhe një aneks (Aneksi XIII) të pezullohet 1.2% dhe të aplikohet në masën 0.6% deri 31.12.2021.

Ndërmarrja nuk merr asnjë raport kthyes (raport të kryerjes së punëve/shërbimeve) për shpenzimet e marketingut që partneri afarist i ka kryer në emër të Telekomit. Kostoja e kompensimit të shpenzimeve të marketingut deri në maj 2021 ndaj OE ishte 49,845€, ndërsa nga qershori deri në dhjetor nuk janë pranuar faturat nga OE.

Kjo kishte ndodhur si shkak i mos specifikimeve të mjaftueshme të kërkesave ndaj OE-së në anekse dhe si rezultat i mos ushtrimit të kontrolleve të mjaftueshme para ekzekutimit të pagesave të shpenzimeve.

Ndikimi

Pagesa e shpenzimeve të marketingut pa pranuar raporte për punën/shërbimin e kryer e cila paguhet në baza të rregullta mujore, përveç që është në mos përputhje me kornizën ligjore lidhur me shpenzimin e parasë publike mund ta dëmtojë edhe buxhetin e ndërmarrjes.

Rekomandimi C3

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që pagesat e shpenzimeve bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e kornizës ligjore në lidhje me shpenzimin e parasë publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera neto e llogarive të arkëtueshme, e prezantuar në PVF ishte 3,152,519€. Ato kanë të bëjnë me arkëtimet ndaj klientëve nga afarizmi i rregullt i kompanisë. Testet tona kanë shpalosur si në vijim:

Çështja A11 - Mos mbyllja e llogarisë së përkohshme kontabël

Gjetja Sipas SNK-ve, llogaria pezull është një llogari e përkohshme dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë ende llogari pezull në kohën kur përgatitet pasqyra e pozicionit financiar.

Në shënimet kontabël ekzistojnë dy llogari të përkohshme (pezull) “Meucci PTK” dhe “Test R&A” me tepricë debitore 55,619€ dhe 25,979€. Këto mjete ndërmarrja nuk ka pretendime për përfitime në të ardhmen, si dhe nuk ka dëshmi mbështetëse të cilat masin vlerën me besueshmëri. Po ashtu, në kartelat analitike nuk ekzistojnë përshkrime të qarta për të kuptuar përmbajtjen e këtyre shumave. Edhe pse vlera e këtyre dy llogarive ishte provizionuar në fund të vitit, ato kishin mbetur pjesë e popullacionit në saldot e llogarive të arkëtueshme bruto.

Sipas konfirmimeve zyrtare, këto llogari ishin hapur për testimin e numrave dhe do të duhej të ishin llogari joaktive pasi që shërbimi i fundit aktiv dhe faturat e fundit kanë qenë që nga vitit 2016 dhe 2018.

Ndikimi Mos mbyllja e llogarisë së përkohshme ndikon në mos prezantimin dhe shpalosjen jo të duhur në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A11 Bordi Drejtues të sigurojë, identifikimin e gjitha transaksioneve të cilat janë të regjistruara në llogaritë e përkohshme dhe trajtimin e tyre sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, në mënyrë që saldo përfundimtare e kësaj llogarie të jetë zero.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A12 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, duhet të prezantoj pozicionin financiar në datën e raportimit, duke prezantuar gjendjen e aktiveve, detyrimit si dhe kapitalin neto, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë.

Zëri i llogarive të arkëtueshme në shpalosjet e pasqyrave financiare ishte prezantuar në vlerën bruto 17,736,411€, mirëpo sipas harmonizimit vjetor midis departamentit të të hyrave dhe kontabilitetit për shërbimet postpaid fiks dhe mobile, ishte reflektuar në nënvlerësim të saldos bruto të llogarive të arkëtueshme me vlerën 12,525€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të bartjeve të faturimeve gjatë vitit në mënyrë manual nga sistemi i departamentit të hyrave në sistemin e kontabilitetit.

Ndikimi

Mungesa e harmonizimeve periodike në sistemin e kontabilitetit dhe sistemin e faturimeve ndikon në mos prezantim të drejtë të informatave financiare në pasqyra.

Rekomandimi A12

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet departamentit të hyrave dhe kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Pamundësia e konfirmimeve për saldot e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Neni 12 Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Vlera e llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e pozitës financiare ishte me vlerë neto 3,152,519€. Për këtë vlerë, ndërmarrja nuk kishte bërë harmonizimin e gjendjeve kontabël me evidencat e debitorëve. Për të testuar saktësinë e tyre, ne kemi dërguar 30 konfirmime te klientët për vlerën 2,467,554€. Prej tyre, kemi pranuar vetëm pesë (5) sish për vlerën prej 324,773€ (evidencat ishin në përputhje), ndërsa për 15 klientë që kemi dërguar letër konfirmim në vlerë 1,521,367€ ndërmarrja kishte iniciuar procedura gjyqësore, dhe për 10 klientët tjerë nuk kemi pranuar fare konfirmime, vlera e të cilave ishte 621,414€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos harmonizimeve të rregullta me klientët, dhe mos përgjigja e klientëve në kërkesat për konfirmimet e kërkuara.

Ndikimi

Në mungesë të harmonizimeve të rregullta paraqitja e llogarive të arkëtueshme në pasqyra financiare mund të mos jetë e saktë dhe mos marrja e veprimeve ligjore me kohë mund të ndikojë që borxhet e tilla të parashkruhen, duke krijuar pamundësi në arkëtimin e borxheve të tilla në të ardhmen.

Rekomandimi B6

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik me partnerët ekonomik ashtu që paraqitja e llogarive të arkëtueshme të jetë e saktë, si dhe të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në kohën e duhur për të gjitha rastet kontestuese të cilat nuk kanë mundur të zgjidhen me marrëveshje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Stoqet

Vlera e stoqeve e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 2,788,000€. Ky zë financiar kryesisht përfshinë materiale, pjesë rezervë, vaj dhe pajisje të ndryshme të cilat janë kryesisht të lidhura me funksionimin e Ndërmarrjes. Ne kemi testuar 11 mostra për teste substanciale si dhe është trajtuar harmonizimi i raportit të regjistrimit të stoqeve me shënimet kontabël. Po ashtu, kemi vëzhguar procesin e numërimit të stoqeve në fund të vitit.

Çështja A13 - Mos harmonizimi i stoqeve në librat e kontabilitetit me raportin e inventarizimit

Gjetja

Sipas Ligjit Nr.06/L- 032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Ndërmarrja në fund të vitit kishte bërë numërimin e stoqeve dhe kishte hartuar raportin për inventarizimin e stoqeve. Komisioni i inventarizimit pas krahasimit me evidencat kontabël ka konstatuar mungesa të stoqeve në vlerë prej 6,784,€ si dhe teprica në vlerë prej 2,236€, por të njëjtat nuk janë trajtuar për të identifikuar shkakun e ndodhjes dhe nuk ishin harmonizuar me librat kontabël. Po ashtu, komisioni i inventarizimit në raportin e tij ka evidentuar stoqe të cilat nuk janë të përfshira në regjistrat kontabël. Për një pjesë të këtyre stoqeve ne kemi pranuar dëshminë për vlerën e tyre (11,714€), ndërsa për një pjesë tjetër nuk ka qenë e mundur përcaktimi i vlerës së tyre. Sipas zyrtarëve, këto janë mallra që janë kthyer në depo të regjioneve pas përdorimit para vitit 2015 kur depot regjionale nuk kanë qenë të hapura në programin e kontabilitetit.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, diferencat e identifikuar nga komisioni nuk ishin në vlerë materiale dhe për këtë arsye nuk ishte bërë harmonizimi i rezultateve të inventarizimit me regjistrat kontabël.

Ndikimi

Mos trajtimi i mungesave dhe tepricave të stoqeve të identifikuar nga komisioni i regjistrimit mund të rezultojë në mbi/nën vlerësimin e stoqeve, raportimin jo të saktë si dhe mundësinë e keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi A13

Bordi Drejtorëve të sigurojë që pas procesit të inventarizimit, të trajtoj shkaqet e diferencave në mes inventarizimit dhe evidencave kontabël.. Po ashtu, të bëjë harmonizimin e gjendjes faktike me gjendjen në librat kontabël, duke identifikuar të gjitha mos harmonizimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e zërit financiar të pasurive afatgjata e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 43,488,169€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me tokën, ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, inventarin, pajisjet dhe softuerët kompjuterik. Ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 28,313,864€. Përveç kësaj, kemi kryer procedurat analitike substanciale për popullacionin në tërësi sa i përket zhvlerësimit.

Çështja A14 - Mos harmonizimi i regjistrit të pasurive me shënimet kontabël si dhe njohja e gabuar e shpenzimeve të zhvlerësimit.

Gjetja

Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, pasqyra e pozicionit financiar duhet të prezantoj pozicionin financiar në datën e raportimit, duke prezantuar gjendjen e aktiveve, detyrimit si dhe kapitalin neto, mbi bazën e të dhënave kontabël në po të njëjtën datë. Të dhënat kontabël duhet të jenë burim i saktë i informacionit për hartimin e pasqyrave financiare. Ndërsa, SNK 16 përcakton që vlera kontabël (neto) e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nuk do të njihet: në nxjerrjen nga përdorimi ose kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij ose shitja. Fitimi ose humbja që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale do të përfshihet në fitim ose humbje nëse zëri nuk njihet. Përfitimet nuk do të klasifikohen si të ardhura.

Analizat tona tregojnë se ka diferenca ndërmjet të dhënave kontabël dhe regjistrit analitik të pasurive. Kjo për faktin se në raportin e komisionit të inventarizimit të pasurive të datës 15.03.2022, ishin klasifikuar si jashtë përdorimi 4,452 pasuri me kosto fillestare 1,958,148€ dhe vlerë të mbetur neto 28,296€, dhe si të humbura 25 pasuri me kosto fillestare 24,498€ dhe vlerë të mbetur neto 1,372€. Për këto pasuri, ndërmarrja kishte bërë shlyerje nga regjistrat kontabël dhe pasqyra financiare, por të njëjtin veprim nuk e kishte bërë edhe në regjistrin analitik të pasurive.

Përveç tjerash, vlerën neto të mbetur të këtyre pasurive (29,669€) ndërmarrja e kishte njohur si shpenzime të zhvlerësimit të vitit dhe jo si humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të pasurive.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, mos harmonizimi i shënimeve në librat kontabël me shënimet në modulën e pasurive ishte si rezultat i vonësive në procesin e inventarizimit. Ndërsa regjistrimi i vlerës neto të mbetur si shpenzime të zhvlerësimit, ishte për shkak të pakujdesisë për trajtimin e çështjeve në përputhje me standardet.

Ndikimi

Mos harmonizimi i regjistrit analitik të pasurive me shënimet kontabël ndikon në informacione çorientuese për përdoruesit. Ndërsa regjistrimet e tilla në kundërshtim me kërkesat e standardeve, kanë ndikuar në mbivlerësim të shpenzimeve të periudhës.

Rekomandimi A14

Kryesuesi i Bordit të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurive, dhe se janë marrë veprimet e duhura përmirësuese në përputhje me standardet e kontabilitetit për harmonizimin e pasurive në mes regjistrit të pasurive dhe shënimeve kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të hyrat

Të hyrat e realizuara ishin në vlerë 58,903,527€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shërbimet e telefonisë mobile, të hyrat nga linjat fikse, të hyrat nga shërbimet e internetit, të hyrat nga kabinat e telefonave publik, të hyrat nga telefona zyrtar dhe të hyrat tjera. Kemi testuar 215 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 21,008,387€.

Çështja A15 - Mospërputhje e të hyrave në mes shënimeve kontabël dhe të dhënave analitike

Gjetja

Sipas SNK 18, të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve do të njihen kur të plotësohet përveç tjerash edhe kushti që “shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme”.

Të hyrat nga Post Paid Fiks, dhe Post Paid Mobile në Departamentin e Sigurimit të Hyrave ishin të regjistruara në vlerë totale 11,724,787€, ndërsa të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave nga shënimet kontabël ishin 11,852,163€. Në krahasim me shënimet në Departamentin e Sigurimit të Hyrave ato ishin mbivlerësuar për 127,376€.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë bërë harmonizime të ndryshimeve në faturime në mes të departamenti të sigurimit të hyrave dhe departamentit të kontabilitetit me rastin e regjistrimit të tyre në librin kryesor.

Ndikimi

Mos harmonizimet në mes shënimeve kontabël dhe shënimeve analitike në departamentin e hyrave ndikojnë që jo të gjitha ndryshimet e ndodhura në departamentin e të hyrave të reflektojnë në sistemin e kontabilitetit.

Rekomandimi A15

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet departamentit të hyrave dhe të kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet që janë prezantuar të dhëna të sakta në pasqyrën e të ardhurave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave ishin 23,559,000€. Më 31 dhjetor 2021, numri i të punësuarve ishte 2,209 (në vitin 2020:2,288). Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 184,849€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A16 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

Gjetja Bazuar në “Politikat e rekrutimit dhe seleksionimit” me nr.01-1176/16 i datës 25.03.2016. Neni 5. Nominimet, Pika 5.3 Caktimi si ushtrues detyre deri në plotësimin e pozitës nuk mund të zgjatë më shumë se 6 muaj.

Gjatë testimeve tona për vitin 2021 kemi vërejtur se 64 pozita mbulohen me Ushtrues Detyre (U.D) përtej afatit të lejuar prej (6) muaj. Rastet e identifikuar ishin:

- U.D Teknik specialist për montim/demontim dhe mirëmbajtje janë tetë (8) zyrtar;
- U.D Menaxher Regjional janë tre (3) zyrtar;
- U.D Udhëheqës i Trajnimeve;
- U.D Udhëheqës i Trajnimeve;
- U.D Koordinator për çështje ligjore;
- U.D Mbikqyrës i Riskut;
- U.D Menaxher i Kontabilitetit, Tatimeve dhe U.D Udhëheqës i Trajnimeve janë me dy (2) zyrtar dhe;
- 61 pozita të tjera janë nga një (1) zyrtar.

Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, emërimi në pozita Ushtrues Detyre është rrjedhojë e implementimit të vendimeve për revokime të pozitave të cilat kanë pasur lëvizje pa përmbushje të kriterëve. Ky emërim është bërë për pozitën vakante sipas nevojave emergjente dhe të domosdoshme të kompanisë, me që ka qenë e pa mundur të hapen konkurse të rregullta, për shkak të natyrës urgjente.

Ndikimi Praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitën të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme në mungesë të konkurrencës së hapur. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi A16 Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të zhvillohen procedura të rekrutimit, që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit si U.D nuk duhet t'i tejkalojë periudhat e përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A17 - Lëvizja e stafit pa kriter prej njëres gradë/pozitë në gradën/pozitën tjetër**Gjetja**

Sipas Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike i publikuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, ndërmarrja do të rekrutojë dhe përkrahë punonjësit pa diskriminim në bazë të përshtatshmërisë së tyre për punë (pika 12). Protokollet tjera të punësimit, përkatësisht pika 12.20 përveç kësaj, ndërmarrja do të inkurajojë dhe ndihmojë punëtorët në të gjitha nivelet e zhvillimit përkatës të aftësive dhe progresit në karrierën e tyre.

Bordi i Drejtoreve Me datë 18.06.2021 kishte marrë vendim që për punësimet e vitit 2018 dhe ato të vitit 2019 të cilët janë graduar me vendime dhe nuk kanë kontratë pune për pozitën aktuale të kthehen në kontratën bazë të punës. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2021 ishin bërë 296 lëvizje të punonjësve nëpër pozita dhe grada (275 raste ju është ulur grada/pozitë ndërsa 21 raste janë rritur në gradë/pozitë). Testimet tona tregojnë që ulja e gradave ishte bërë edhe për 31 të punësuar të cilët kishin kontratë pune me afat të caktuar.

Kjo ka ndodhur si shkak i mungesës së kriterëve të përcaktuara qartë në Politikën e brendshme të Seleksionimit dhe Rekrutimit për lëvizjet e stafit. Po ashtu, menaxhmenti kishte bërë anulimin e këtyre kontratave duke i konsideruar si të jashtëligjshme, pasi ato ishin lidhur pa procedura të konkursit.

Ndikimi

Në mungesë të një politike të qartë për avancimet, rritet rreziku për trajtim jo të barabartë dhe mund të krijojë diskriminim në gradimet dhe degradimet e stafit.

Rekomandimi A17

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, hartimin e rregullores të gradimeve/degradimeve të punonjësve, në mënyrë që lëvizjet e tyre prej njëres gradë në tjetrën, të bëhen në bazë të kriterëve të vendosura në rregullore/politikë, e cila duhet të jetë e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Mangësi në procesin e avancimit në pozitë përmes konkursit të brendshëm****Gjetja**

Në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017 Për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 4. Shpallja e vendeve të lira të punës pika 1. Konkursi publik për plotësimin e vendeve të lira të punës, pika 6. Përfshihet nga paragrafi 1 i këtij neni, organi përkatës i autorizuar me Statutin apo Aktin e Brendshëm duhet fillimisht të shpallë konkurs të brendshëm, nëse ka më shumë se një kandidat/e të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës.

Në konkursin e brendshëm të datës 12 maj 2021 për poziten “Menaxher Regional Gjilan”, kishin aplikuar gjithsej pesë (5) aplikant dhe sipas komisionit përzgjedhës tre (3) prej tyre i kishin plotësuar kushtet dhe kriteret, mirëpo sipas analizave tona vetëm njëri nga aplikantët i kishte plotësuar të gjitha kriteret e konkursit të shpallur i cili edhe ishte përzgjedhur. Ndërsa katër (4) të tjerët nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs. Në këtë rast do të duhej të shpallet konkurs publik.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos ekzaminimit të duhur të dokumenteve të aplikantëve nga ana e komisionit vlerësues.

Ndikimi

Përzgjedhja e stafit në mungesë të konkurrencës se hapur në rastet kur nuk ka staf të mjaftueshëm të brendshëm që i plotësojnë kriteret për pozitën e caktuar, rrit rrezikun e angazhimit të personave jo kompetent dhe mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të ndërmarrjes.

Rekomandimi B7

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në rastet kur nuk ka kandidatë të mjaftueshëm të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës, të aplikohen procedurat e konkursit publik në mënyrë që përzgjedhja e stafit të jetë në harmoni me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mos pagesa e punonjësve me gradë të njëjtë për pozitën e njëjtë

Gjetja

Sipas Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, neni 55 specifikohet se punëdhënësi duhet t'i paguajë punonjësit kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensimin i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat tjera.

Analizat tona të listës së pagave të punonjësve, tregojnë se për 54 pozita, punonjësit nuk paguhën me grada të njëjta për pozitën e njëjtë. Vlen të ceket se ndërmarrja ende nuk ka rregullore për sistematizim të vendeve të punës.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje është paraparë që të rregullohet me ristrukturim i cili proces është në fazën përfundimtare. Vlen të ceket se ndërmarrja ende nuk ka rregullore për sistematizim të vendeve të punës.

Ndikimi

Pagesa e punonjësve për pozita të njëjta me grada të ndryshme mund të ndikojë në ngritjen e padive eventuale ndaj Ndërmarrjes për mostrajtim të barabartë dhe rrjedhimisht humbje financiare të saj.

Rekomandimi B8

Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta të paguhën me grada të ndryshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë.

Çështja B9 - Mos realizimi i planit vjetor të auditimit

Gjetja

Sipas Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte planifikuar të kryej gjashtë (6) auditime për vitin 2021.

Në 29.09.2021 ishte bërë rishikimi i planit dhe të gjitha auditimet e përfshira në planin fillestar ishin ndryshuar sepse deri në atë periudhë nuk ishin realizuar asnjë nga auditimet e parapara. Në planin e rishikuar ishin parapa gjashtë (6) auditime të reja. Po ashtu, ishin planifikuar edhe dy (2) auditime ad-hoc me kërkesë të Bordit të Drejtorëve.

Për vitin 2021, Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte arritur të finalizoj pesë (5) prej tetë (8) auditimeve të planifikuara në planin e rishikuar, dy prej të cilave ishin me kërkesë të Bordit.

Sipas zyrtarëve të Njesisë ky mos realizim i planit kishte ndodhur kryesisht për shkak të situatës pandemike, ku pothuajse për periudhën e parë të vitit 2021, Njësia e Auditimit nuk kishte qenë pjesë e stafit esencial por është munduar të përshtatet me rrethanat të reja dhe të punojë nga shtëpia. Po ashtu, në mos realizimin e planit kanë ndikuar edhe ndërrimet e shumta në përbërjen e njesisë.

Ndikimi

Mos realizimi i planit vjetor të Njesisë së Auditimit të Brendshëm zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontroleve në kompani. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të rezultojnë me humbje financiare për kompaninë.

Rekomandimi B9

Bordi i Drejtorëve të sigurojë përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe monitorim efektiv nga Komiteti i Auditimit, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 kishte rezultuar në 17 rekomandime për pasqyra financiare dhe 12 rekomandime për sistemet informative. Telekom i Kosovës sh.a, kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, katër (4) rekomandime ishin zbatuar; tre (3) ishin zbatuar pjesërisht; një (1) nuk aplikohet më, ndërsa nëntë (9) rekomandime nuk janë adresuar ende (shih Grafikun 1). Rekomandimet e dhëna për sistemet informative nuk ishin testuar gjatë vitit 2021 për shkak se Kompanisë i është lënë kohë më e gjatë për adresimin e tyre, dhe testimi i tyre do të bëhet në auditimin e radhës. Ndërsa, në Tabelën 1 është paraqitur një përshkrim më i plotë i rekomandimeve dhe mënyra se si janë trajtuar ato.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2021

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se është bërë një analizë e detajuar për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikim të Opinionit dhe të merren veprimet e nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar. Pasqyrat financiare të Kompanisë duhet të përgatiten në një bazë e cila është e përshtatshme dhe e bazuar në realitetin ekonomik të Kompanisë. Nënshkrimi i pasqyrave nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar duhet të bëhet vetëm nëse ndaj Pasqyrave Financiare Vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit të Drejtorëve.	Gjendja mbetet e pandryshuar. Menaxhmenti kishte ndërmarrë disa veprime të cilat ishin të pamjaftueshme për të siguruar pagesat e detyrimeve në kohë në rrjedhë normale të biznesit.	Nuk ka filluar zbatim

2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente dhe pasuri kontingjente, të jepen informacione shpjeguese për to në shpalosjet dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi identifikuar që shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion për ngjarjet të cilat plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në përgatitjen e pasqyrave financiare. Të bëhen korrigjimet adekuate në kontabilitet ashtu që të hyrat nga granti të njihen dhe detyrimet ndaj grantit të zvogëlohen në periudhën e saktë dhe në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.	Ndërmarrja gabimet e identifikuar në vitin e kaluar i kishte korrigjuar. Mirëpo, kemi identifikuar gabime tjera të natyrës së ngjashme në regjistrimin e të hyrave nga grandet gjatë vitit 2021.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se regjistri i obligimeve rishikohet periodikisht dhe bëhet harmonizimi i kartelave të llogarive në mënyrë sistematike në mes Kompanisë dhe furnitorëve. Përveç kësaj, të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar gabimet e identifikuar në shënimet kontabël dhe të siguroj prezantim të saktë në pasqyra financiare.	Ndërmerrja as në vitin 2021 nuk kishte aplikuar procesin e harmonizimit periodik me operatorët në mënyrë që të konfirmohet saktësia e llogarive të pagueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik me partnerët ekonomik ashtu që paraqitja e llogarive të arkëtueshme të jetë e saktë si dhe të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në kohën e duhur për të gjitha rastet kontestuese të cilat nuk kanë mundur të zgjidhen në mënyrë bilaterale.	Edhe në vitin 2021 çështja mbetet e njëjtë. Kjo për faktin se ndërmarrja nuk kishte bere harmonizime periodike me partneret ekonomik.	Nuk ka filluar zbatimi

6.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të saj.	Çështjet e ngritura në lidhje me të hyrat, shpenzimet dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se gabimet e identifikuar në PFV-të tjera të cilat reflektojnë në Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë korrigjohen para përgatitjes së pasqyrave të vitit aktual në mënyrë që shifrat krahasuese në mes të viteve të jenë të sakta dhe të plota.	Ky rekomandim mbetet i pazbatuar. Kjo sepse çështjet e ngritura për zërat kontabël si, të arkëtueshmet, pagueshmet, parapagimet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteteve operative të rrjedhës së parasë, kanë ndikuar në prezantim të një informacioni të saktë.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se llogaritë e arkëtueshme njihen vetëm kur plotësohen kushtet për njohjen e tyre sipas standardeve të kontabilitetit, ndërsa në rastet kur mundësia e arkëtimit varet nga vendimet e gjykatës ato të njihen si aktive të kushtëzuara dhe të jepen shënime sqaruese për to. Më tutje, Bordi të sigurojë se janë bërë korrigjimet në vlerën e llogarive të arkëtueshme aktuale në mënyrë që pasqyrat financiare të vitit të 2020 të prezantojnë vlerën e saktë.	Ndërmarrja gjatë vitit 2021 kishte bërë korrigjimet e duhura duke i zvogëluar llogaritë e arkëtueshme për vlerën e prezantuar.	I zbatuar

9.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që vendimet për të ndryshuar kushtet e kontratës, të jenë të bazuara në analiza paraprake të përshtatshmërisë ekonomike, për të evituar efektet financiare negative nga vendimet e pafavorshme për Kompaninë.	Gabimet e njëjta kishin ndodhur deri në muajin maj 2021. Ndërsa, tutje ndërmarrja nuk i ka regjistruar shpenzimet në bazë të kushteve të ndryshuara të kontratës, por operatori ka vazhduar të faturoj ngjashëm si në vitin e kaluar.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që pagesat e shpenzimeve behën në përputhje të plotë me kërkesat e kornizës ligjore në lidhje me shpenzimin e parasë publike.	Deri në maj 2021 ndërmarrja kishte pranuar fatura për shërbime të marketingut pa raporte mbështetëse që dëshmojnë shërbimet e realizuara. Ndërsa nga kjo periudhë e tutje ndërmarrja nuk kishte pranuar faturat nga OE.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se regjistri i obligimeve rishikohet periodikisht dhe bëhet harmonizimi i kartelave të llogarive në mënyrë sistematike në mes Kompanisë dhe furnitorëve. Për më tepër, të siguroj që janë marrë veprimet e nevojshme ligjore në rastet kontestimore.	Në vitin 2021 nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar
12.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë vendime për kryerjen e procedurës për testim të rënies në vlerë të pasurive duke dokumentuar atë sa më qartë, në mënyrë që të prezantohet një vlerë reale e pasurive dhe të eliminohen mundësitë e keq deklarimit të shpenzimeve në pasqyra financiare.	Për këtë vit, kjo çështje nuk është e aplikueshme, pasi vlera neto e tyre është shumë e vogël.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se merren masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të punonjësve të rinj, si dhe respektimin e afatit maksimal të lejuar me ligj në rastin e punonjësve me kontratë dhe detyra specifike.	Gjatë vitit ndërmarrja kishte marr veprime për këtë çështje.	I zbatuar

14.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësojnë që punonjësit në pozitë të njëjta të paguhet me grada të ndryshme.	Analizat tona të listës së pagave të punonjësve, tregojnë se për 54 pozita, punonjësit nuk paguhet me grada të njëjta për pozitën e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
15.	Shpenzimet e pagave	Bordi i drejtorëve të sigurojë, që punësimi i stafit të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara për pozitën e shpallur me konkurs.	Gjatë vitit 2021 ndërmarrja nuk ka realizuar procedura të jashtme të rekrutimit.	I zbatuar
16.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në rast të avancimit të punëtorëve, kandidatët e suksesshëm t'i kenë plotësuar kushtet dhe kriteret për pozitën e shpallur me konkurs të brendshëm, në të kundërtën të anulohet konkursi.	Edhe gjatë vitit 2021 janë vërejtur mangësi në procesin e avancimit në pozitë përmes konkursit të brendshëm.	Nuk ka filluar zbatim
17.	Funksioni i auditimit të brendshëm	Bordi i Drejtorëve të sigurojë përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe monitorim efektiv nga Komiteti i Auditimit, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.	Edhe në vitin 2021 nuk ishte përmbushur plani vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.	Nuk ka filluar zbatim
18.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë se para vendosjes së BTS-ave bëhen matje dhe analiza të detajuara në planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit në pajtim me procedurat standarde të operimit të Departamentit Teknik në mënyrë që çdo BTS të ketë mbulueshmëri sa më të mirë të zonave dhe kualitet sa më të lartë të shërbimit.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
19.	Sistemet Informative	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që është bërë ndërlidhja ndërmjet sistemeve CRM dhe ERP në mënyrë që të dhënat për transaksionet e pagesave të faturave 'PostPaid' në pikat shitëse të raportohen në baza ditore.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
20.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që të dhënat nëpër sistemet e informacionit të jenë të harmonizuara. Gjithashtu, në vazhdimësi të monitorohen sistemet e informacionit dhe të trajtohen kontrollet e gabimeve që shfaqen gjatë harmonizimit të të dhënave për konsumatorë.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më

21.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që sistemi i alarmeve për identifikim të mashtrimeve dhe rreziqeve të jetë funksional dhe të ndërmarrë masa adekuata për identifikimin e shpejt dhe parandalimin e incidenteve, në mënyrë që të ruhet besimi i konsumatorëve dhe minimizohen humbjet e mundshme financiare.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
22.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që në sistemin e CRM-së të funksionalizohen fushat e obligueshme të identifikimit për regjistrimin e konsumatorëve, në mënyrë që të pamundësohet aktivizimi i shërbimit pa u regjistruar konsumatori. Përveç kësaj, të bëhet ndërlidhja e sistemit CRM me sistemin e Agjencisë së Regjistrimit Civil për validimin e numrit personal dhe sistemin e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës për validimin e numrit unik të biznesit.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
23.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që në sistemin CRM janë zhvilluar mekanizmat që kontrollojnë dhe kufizojnë regjistrimin e më shumë se dhjetë SiM kartelave për të gjithë konsumatorët fizik në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
24.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që janë krijuar mekanizmat për monitorimin e aktiviteteve të përdoruesve, përkatësisht platforma për monitorimin e tyre, janë përcaktuar përgjegjësit për monitorim dhe monitorimi i aktiviteteve është duke u bërë në periudha të rregullta kohore.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
25.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që monitorimi i përdoruesit me qasje të plota të bëhet në vazhdimësi si dhe të gjitha llogarit të jenë të personalizuara me qëllim të ruajtjes së integritetit të të dhënave dhe disponueshmërisë së sistemeve të informacionit.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
26.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë, që të drejtat e qasjes në përdorimin e sistemeve të informacionit të ndërpriten menjëherë për punonjësit, në momentin e ndërprerjes së kontratës.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
27.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që është hartuar dhe miratuar procedura për rishikimin e të drejtave të qasjes së përdoruesve në sistemet e informacionit, si dhe të sigurojë se po bëhet rishikim në baza të rregullta periodike i roleve dhe përgjegjësi të përdoruesve për t'u siguruar që ato janë të vlefshme dhe të përshtatshme për funksionin e punës së përdoruesve.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më

28.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që kompleksiteti i fjalëkalimeve po zbatohet në sistemet e informacionit.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më
29.	Sistemet Informative	Bordi i drejtorëve të sigurojë që në afat sa më të shpejtë të bëjë implementimin e plotë të kodit shtetërorë të Kosovës.	Vlerësimi do të bëhet në auditimet e radhës.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Krenare Pirana, Anëtare e ekipit



Valbona Pllana, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre	Nuk Pajtohem - Nuk ka bazë të qartë ligjore që e kufizon caktimin e ushtrueseve të detyrave për kohë të caktuar. Telekomi është në proces të ristrukturimit, nga ky proces pritet të ketë ndryshim të strukturës organizative të kompanisë, hapja e konkurseve dhe nënshkrimi i kontratave për pozita që në të ardhmen mund të mos ekzistojnë, mund të shpie kompaninë drejt futjes në obligime kontraktuale me punëtorë për pozita të cilat në të ardhmen mund të mos ekzistojnë. KE ka kompetenca të sigurojë funksionimin e kompanisë duke plotësuar përmes emërimeve stafin në pozitat përkatëse organizative.	Gjetja qëndron sepse bazuar në "Politikat e rekrutimit dhe seleksionimit" të ndërmarrjes me nr.01-1176/16 i datës 25.03.2016. Neni 5. Nominimet, Pika 5.3 Caktimi si ushtrues detyre deri në plotësimin e pozitës nuk mund të zgjatë më shumë se 6 muaj. Pra, politikat që i bën vet Telekomit, duhet edhe t'i zbatohet. Përndryshe, këtë koment ia drejtoni drejtuesve të lart të Telekomit pse është aprovuar si të tillë.
Mos mbyllja e llogarisë së përkohshme kontabël	Pajtohem pjesërisht - Llogaria në fjalë nuk është llogari kontabël, por llogari në sistem të faturimit e cila ka shërbyer për thirrje nga numrat testues. Vitet e kaluara ka qenë numër më i madhe i thirrjeve, por viteve të fundit numri i thirrjeve është reduktuar në minimum. Gjendja e kësaj llogarie është korrigjuar përmes provizioneve për borxhe të këqija prandaj nuk ka ndikim në prezantim të pasqyrave financiare, por mund të ketë ndikim vetëm në shpalosje.	E gjetura qëndron pasi sipas SNK-ve, llogaria pezull është një llogari e përkohshme dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë ende llogari pezull në kohën kur mbyllet llogaritë e fundvitit. Në paragrafin e fundit të komentit të entitetit potencohet që mund të ketë ndikim vetëm në shpalosje. Sipas SNK1 pasqyra e shpalosjeve është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare dhe nuk mund të trajtohet ndaras ose si pasqyrë e pa rëndësishme siç është pretenduar nga menaxhmenti i ndërmarrjes në këtë koment.

Pamundësia e konfirmimeve për saldote të llogarive të arkëtueshme	Nuk pajtohem - Fakti që nuk bëhet harmonizim formal i gjendjes me debitorët, dhe debitorët nuk përgjigjen në kthimin e letër konfirmimeve ose eventualisht nuk konfirmojnë saldote që ekzistojnë sipas sistemit tonë të kontabilitetit nuk do të thotë që kompania jonë ka bërë prezantim të pasaktë të balancave të tyre. Ekzistojnë shumë arsye që debitorët të mos kthejnë letër konfirmime ose të kthejnë me vlerë që nuk përputhen me balancat tona. Ekzistojnë procedura tjera që auditorët mund të ndërmarrin për të vërtetuar saktësinë e balancave tona. Ne u kemi ofruar çdo dokumentacion të kërkuar nga ju për të verifikuar saktësinë e balancave të debitorëve që prezantojmë në pasqyrat tona financiare. Nuk na është prezantuar asnjë rast që auditorët kanë gjetur se gjendjet e debitorëve të paraqitura në pasqyra financiare nuk janë të sakta. Ne kemi dhjetëra mijëra debitorë dhe është praktikisht e pamundur që të bëjmë harmonizime formale të dokumentuara të rregullta me të gjithë debitorët. Të gjitha gjendjet e debitorëve që janë përfshirë në pasqyra financiare janë të mbështetura me dokumentacion përkatës.	Gjetja qëndron pasi kjo çështje ka qenë e trajtuar edhe në raportin e vitit të kaluar për të cilën menaxhmenti i Telekomit ishte pajtuar. Edhe në këtë vit mbetet çështja e njëjtë pasi që ndërmarrja nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për harmonizimin e kartelave të llogarive mes ndërmarrjes dhe debitorëve. Për më shumë, shih edhe komentimin e dhënë lidhur me çështjen Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme tregtare për llogaritë e pagueshme, pasi që kërkesa e harmonizimeve është e njëjtë.
--	---	--

Përdorimi i papërshtatshëm i Bazës Kontabël të Vijimësisë	Nuk pajtohem - Në pasqyrat Financiare kemi shpalosur plotësisht rreziqet që e kërcënojnë Parimin e Vijimësisë, po ashtu kemi shpalosur edhe veprimet që kemi ndërmarrë dhe ngjarjet për të iu përgjigjur këtyre rreziqeve. Në vlerësimin e kërcënimeve të parimit të vijimësisë rreziqet duhet të maten në bazë të gjasës që të ndodhë ngjarja dhe madhësia e efekteve të atyre ngjarjeve. Sipas IAS 1, Parimi i Vijimësisë: nëse menaxhmenti vlerëson se ka pasiguri serioze lidhur me parimin e vijimësisë, atëherë duhet që këto pasiguri të i shpalosë në pasqyrat financiare. Nëse menaxhmenti konkludon që kompania nuk ka vijimësi, atëherë pasqyrat financiare nuk duhet të përgatiten mbi bazën e parimit të vijimësisë. Meqenëse menaxhmenti ka bërë shpalosjet e nevojshme në pasqyrat financiare lidhur me shqetësimet e vijimësisë, auditori duhet të paraqes opinionin në përputhje me SNA 570 paragrafi 17,18,19,20 dhe 22. Meqenëse çështja B1, është çështja kryesore që ndikon në dhënien e Opinionit të Kundërt, për shkak të Parimit të Vijimësisë, ne vlerësojmë që nuk ka bazë për opinion të kundërt për shkak të parimit të vijimësisë.	Komenti është krejtësisht i pa bazë. Për shtatë vite me radhë, kompania operon me humbje dhe humbjet e akumuluar arrijnë shumën mbi 76 milionë euro, ndërkohë që ka edhe një ekuitet negativ prej 16.8 milionë euro. Kjo do të thotë se edhe po të shiteshin të gjitha pasuritë e Telekomit, nuk mund t'i mbulojnë detyrimet e kompanisë për të njëjtën shumë. Veç kësaj, vetëm detyrimet afatshkurtra të kompanisë janë mbi 70 milionë euro, që duhet të paguhen brenda vitit 2022, ndërkaj kompania të hyrat totale për 2021 i kishte 59 milionë. Kompania nuk është e aftë të paguaj as tatimet në paga, madje as kontributet pensionale të punëtorëve, me çka cenon të drejtën elementare të punëtorëve për pension. Marrë parasysh faktin se edhe të gjithë treguesit tjerë financiar në raport janë negativ, si dhe historikun e katër viteve të fundit që kompania ka pasur në vazhdimësi opinion të kundërt, kjo hedhë poshtë të gjitha komentet lidhur me opinionin. Përndryshe, këto që u thanë më lart janë tregues i kërcënimeve serioze të cilat kompania nuk i ka shpalosur në mënyrë të mjaftueshme apo që në forma të ndryshme i ka minimizuar.
--	---	--

Shpalosja jo e saktë dhe mos dhënia e informacioneve shpjeguese për kontigjencat	Nuk pajtohem - Ky gabim është vërejtur gjatë procesit të auditimit, kemi kërkuar që të bëhet përmirësimi, sipas Standardit Ndërkombëtare të Auditimit SNA 700, por përmirësimi nuk është lejuar. Siç jeni në dijeni, ky gabim është identifikuar gjatë procesit të auditimit nga vet menaxhmenti i Telekomit dhe janë njoftuar auditorët. Vlen të ceket se edhe në vitet 2019 dhe 2020 shpalosja e kontingjenteve ka qenë e prezantuar gabimisht në vlerë akoma më të madhe, dhe ky fakt nuk është vërejtur as nga menaxhmenti e as nga auditori. Zyra Ligjore për shkak edhe të ngarkesës së madhe në punë, nuk ka hequr nga lista e padive që janë ushtruar ndaj Telekomit disa padi që janë mbyllur në favor të Telekomit gjatë vitit 2022 para përgatitjes së Pasqyrave Financiare (rasti i padisë nga Dardafon i marrë në Shkurt 2022 në vlerë 50 Milion €), por edhe disa raste tjera në vlera të mëdha që janë mbyllur në favor të Telekomit gjatë viteve të mëhershme. Pas korrektimit të listës vlera e padive të prezantuara në shpalosje të pasqyrave në shumë prej mbi 82 milion €, zvogëlohet në shumën totale mbi 18 milion €. Kjo vlerë ka të bëjë vetëm me shpalosjen. Para përfundimit të procesit të auditimit kemi kërkuar nga ana juaj që të na mundësohet që shpalosja në shënimin 25 të Pasqyrave Financiare të përmirësohet, pasi që bëhet fjalë për keqkuptim.	Komenti është i pa arsyeshëm. Kërkesa për korrigjime të pasqyrave është bërë një ditë para se të përfundoj auditimi. Meqenëse Telekomit është vonuar 37 ditë në dorëzimin e Pasqyrave, ne nuk kemi qenë në gjendje të japim afate shtesë për korrigjime. Për shkak të këtyre vonesave, kjo mundësi nuk i është dhënë asnjë ndërmarrjeje për shkak se kjo do t'i shkaktoje ZKA-së vonesa në arritjen e afateve për dorëzimin e raporteve. Prandaj, ne rekomandojmë menaxhmentit të ndërmarrjes që t'i aplikojë SNK dhe SNRF-të që të mos kenë nevojë për afate shtesë për korrigjime të Pasqyrave. E dyta, nëse këto gabime kanë qenë edhe gjatë vitit 2019 dhe 2020 dhe nuk janë zbuluar nga auditimi, kjo nuk do të thotë se ato lejohet të përsëriten pafundësisht. Komentet e menaxhmentit gjithmonë lidhen me ngarkesa të mëdha në punë, dhe siç shihet nga numri i komenteve, Telekomit rrallëherë është i gatshëm t'i pranojë gabimet apo parregullsitë e veta në raportim.
---	---	---

Prezantimi jo i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet	Nuk pajtohem - Ne vlerësojmë dhe qëndrojmë mbrapa prezantimit që kemi bërë në pasqyra financiare të ndihmës që kemi pranuar nga Aksionari në shumë prej 10 milion € në fund të muajt Dhjetor 2021. Prezantimi i kësaj ndihme në pasqyrat financiare është bërë në përputhje të plotë me IAS 20. Destinimi i kësaj ndihme ka qenë pagesa e obligimeve të grumbulluar ndaj ARKEP. Një pjesë e këtyre obligimeve lidheshin me fatura të shpenzimeve të kaluara. Këtë pjesë të ndihmës që lidhet me këto fatura e kemi njohur si të hyra nga subvencionet e qeverisë. Pjesa tjetër e ndihmës lidhej me pagesën e tri kësteve nga rreth 1.2 milion € secila, që ka të bëjë me 6 vite të licencës së lëshuar nga ARKEP (3 vite të kaluara dhe 3 vitet e ardhshme). Pjesën e ndihmës që është ndërlidhur me pjesën e licencës për 3 vitet e kaluara e kemi njohur si të hyra, ndërsa pjesën tjetër që lidhet me 3 vitet e ardhshme e kemi njohur si detyrim i të hyrave të shtyra dhe e njëjta do të njihet si e hyrë e rregullt 3 vitet e ardhshme ashtu siç amortizohet licenca. Në marrëveshjen për ndihmë nga Qeveria ka qenë e specifikuar destimi për pagesën e obligimeve të grumbulluara deri në atë kohë ndaj ARKEP. Sapo kemi pranuar ndihmën është bërë pagesa e plotë e obligimeve të arritura deri në atë periudhë. Ne nuk kemi asnjë obligim tjetër ndaj marrëveshjes në fjalë për ndihmë qeveritare, prandaj janë plotësuar kushtet për njohjen e ndihmës si e hyrë. Mbajtja si obligim i të hyrave të shtyra për 17 vitet ardhshme për një marrëveshje ndaj së cilës nuk kemi asnjë obligim, nuk do të ishte prezantim i drejtë obligimeve në pasqyra financiare për vitet e ardhshme.	E gjetura qëndron, pasi edhe komenti i prezantuar nga entiteti nuk është relevant për këtë çështje, sepse entiteti ka bërë njohjen e të hyrave të shtyra duke u bazuar në marrëveshjen me ARKEP të vitit 2019 për pagesën e obligimeve (10 vite) dhe jo sipas marrëveshjes së aksionarit. Si rrjedhojë, jetëgjatësia e amortizimit të grantit nuk përputhet me jetëgjatësinë e amortizimit të pasurisë me të cilën lidhet granti siç kërkohet me SNK 20.
Prezantim jo i drejtë i parapagimeve	Nuk Pajtohem - Në shpalosjen 11 të pasqyrave është prezantuar që	Gjetja e auditimit qëndron për faktin se ndërmarrja do të duhej të

bëhet fjalë për shpenzim të shtyrë. Kontrata që Telekom ka nënshkruar me një qiradhënë para shume viteve dhe e ndryshuar disa herë, përherë të fundit në vitin 2017, parashihte që në muajin Maj 2021 të bëhej parapagimi i qirasë nga Telekom për dy vitet e ardhshme. Qiradhënësi në përputhje me kontratën ka lëshuar faturën në vlerë 544,310€ që përfshinte qiranë për dy vitet e ardhshme. Për shkak të gjendjes së rënduar financiare Telekom nuk kishte mundësi të parapaguajë qiranë për dy vite e ardhshme. Kemi kërkuar mirëkuptim nga qiradhënësi që të na mundësoj pagesën me këste të kësaj fature. Qiradhënësi fillimisht ka refuzuar dhe përmes përmbaruesit ka iniciuar inkasimin e vlerës së faturës tashmë të lëshuar. Pas negociatave me qiradhënësin kemi arritur marrëveshje që qiraja të paguhej me këste për 24 muaj, por edhe përkundër insistimit tonë që fatura e lëshuar nga qiradhënësi për vlerën e plotë të qirasë të anulohet dhe faturimi i qirasë të bëhet në baza mujore, qiradhënësi refuzonte një gjë të tillë dhe arritëm që kjo të futet në marrëveshje. Ne vlerësojmë se kjo formë e regjistrimit nuk ka ndikuar në mbi vlerësimin e përgjithshëm të detyrimeve dhe aseteve në Pasqyra Financiare sepse edhe regjistrimi në formën tjetër sipas SNK 16, duke rritur Asetet nga e drejta e shfrytëzimit dhe Detyrimet nga e drejta shfrytëzimit, efektivisht kanë reflektim të njëjtë në pasqyrat financiare. Ekziston një dallim mes obligimeve që rrjedhin nga kontrata e qirave sipas SNK 16, kontratë e cila mund të ndërpritet, dhe faturës së lëshuar në emër të kontratës e cila nuk mund të ndërpritet. Fatura përmban edhe TVSH-në dhe regjistrimi i saj si transaksion nga e drejta e shfrytëzimit të asetit ka ndikim në mos përputhje të deklarimit të TVSH-së mes kompanisë dhe qiradhënësit që ka	regjistronte vlerën totale të marrëveshjes së qirasë sipas SNRF 16, të zëri Asetet nga e drejta e shfrytëzimit dhe Detyrimet nga e drejta e shfrytëzimit. Ndërsa për këtë, ndërmarrja kishte njohur vlerën në kuadër të zërit shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera (edhe pse ndërmarrja nuk e kishte parapaguar vlerën totale të marrëveshjes), dhe njëkohësisht si obligime të periudhës. Kjo ka ndikuar në prezantim jo të drejtë të tyre.
--	---

	lëshuar faturën.	
Mos prezantim i saktë i llogarive të pagueshme tregtare	Nuk pajtohem - Fakti që nuk nuk bëhet harmonizim formal i gjendjes së borxheve me kreditorët, dhe kreditorët nuk përgjigjen në kthimin e letër konfirmimeve ose eventualisht nuk konfirmojnë saldot që ekzistojnë sipas sistemit tonë të kontabiliteti nuk do të thotë që kompania jonë ka bërë prezantim të pasaktë të balancave të tyre. Ekzistojnë shumë arsye që kreditorët dhe debitorët të mos kthejnë letër konfirmimet ose të kthejnë me vlerë që nuk përputhen me balancat tona. Ekzistojnë procedura tjera që auditorët mund dhe duhet të ndërmarrim për të vërtetuar saktësinë e balancave tona. Ne u kemi ofruar çdo dokumentacion të kërkuar nga ju për të verifikuar saktësinë e balancave të kreditorëve që prezantojmë në pasqyrat tona financiare. Nuk na është prezantuar asnjë rast që auditorët kanë gjetur se gjendjet e kreditorëve të paraqitura në pasqyra financiare nuk janë të sakta. Ne kemi mijëra kreditorë dhe është praktikisht e pamundur që të harmonizime formale të dokumentuara të rregullta me të gjithë kreditorët. Të gjitha gjendjet e kreditorëve që janë përfshirë në pasqyra financiare janë të mbështetura me dokumentacion përkatës.	Komenti është i pa bazuar, dhe gjetja në raport nuk ndryshon. Ndërmarrja nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për të harmonizuar kartelat e saj me furnitorët. Nëse menaxhmenti e pohon faktin se ekzistojnë mijëra kreditorë, auditorët nuk mund ta konfirmojnë një për një saktësinë e të gjitha këtyre llogarive. Ju kujtojmë se vetëm për katër llogari, konfirmimet e jashtme kanë rezultuar me diferenca prej 355,125€. Prandaj, është i pasaktë koment i entitetit se në asnjë rast që auditorët nuk kanë gjetur se gjendjet e kreditorëve të paraqitura në pasqyra financiare nuk janë të sakta. Sa i përket konkluzionit të tyre se është praktikisht e pamundur që të ketë harmonizime formale të dokumentuara të rregullta me të gjithë kreditorët, kjo as që është kërkuar nga ne, por, ajo që ne mendojmë është se me kreditorët të cilët përbëjnë shumatat domethënëse të llogarive, harmonizimet duhej të ishin kryer. Por, ndërmarrja nuk kishte marrë asnjë veprim për harmonizimin e gjendjeve dhe siguria e jonë për gjendjen e vërtetë të këtyre llogarive është shumë e limituar.

Prezantim i pasaktë i të drejtave të shfrytëzimit të pasurive	Nuk pajtohem - Gjatë vitit 2021 kompania nuk ka nënshkruar kontrata të qirasë në vlerën e paraqitur në raport të auditimit. Një kontratë qiraje në vlerë mujore 550€ gabimisht nuk është përfshirë në listën e të drejtave për shfrytëzim të aseteve. Pjesa 326,740€ lidhet me çështjen A1 dhe sipas nesh trajtohet si klasifikim jo i duhur, e jo nënvlerësim i aseteve, detyrimeve dhe shpenzimeve.	Gjetja qëndron dhe komenti është i pa bazë. Kjo ndërlidhet me sqarimet e prezantuara lidhur me çështjen A1. Përveç tjerash, në kuadër të këtij zëri nuk ishte përfshirë fare vlera e një kontrate të qirasë në vlerë totale 29,970€.
Prezantim i pasaktë i provizioneve	Nuk pajtohem - kjo e gjetur lidhet me të gjeturën B2, ku ne kemi kërkuar përmirësim të pasqyrave.	Shih më lart komentin lidhur me çështjen Shpalosja jo e saktë dhe mos dhënia e informacioneve shpjeguese për kontigjentet.
Prezantimi i pasaktë i detyrimeve afatshkurta	Nuk pajtohem - nga shuma e prezantuar nga auditori 362,431€, shuma prej 285,800€ janë parapagime të klientëve, pjesa tjetër janë pagesat nga klientët që nuk janë identifikuar se për cilët klient bëhet fjalë (mjetet e paalokuara, që lidhet me çështjen A7). Telekomi ka të ndarë sistemin e faturimit për klientët nga sistemi i kontabilitetit. Çdo e hyrë dhe pagesë fillimisht regjistrohet në sistemin e faturimit, për shkak të numrit të madh të klientëve ndonjë klient mund të bëjë pagesa më shumë sesa vlera e faturimit dhe ato pagesa regjistrohen në llogarinë e atij klienti në sistemin e faturimit. Këto pagesa mund të ndodhin në shuma të vogla nga shumë klientë. Në sistemin e kontabilitetit këto pagesa regjistrohen si arkëtime nga llogaritë e arkëtueshme. Ne vlerësojmë se regjistrimi si të hyra të shtyra fillimisht dhe pastaj bartja në të hyra të rregullta i një numri të madh të transaksioneve me vlera relativisht të vogla, kërkon korrigjime të vazhdueshme gjatë tërë vitit. E gjetura qëndron, por meqenëse se bëhet fjalë për diferenca të përkohshme dhe nuk janë material, përgjithësisht nuk ka ndikim në prezantim çorientues të pasqyrave financiare në tërësi.	Koment kontradiktor dhe i pa qartë. Në fillim entiteti e potencon që nuk pajtohem, dhe në fund të këtij komenti thuhet se gjetja qëndron. Nga komenti nuk mund të kuptohet se cila është e saktë. Tjetër, se sa diferencat janë materiale, mbetet në gjykimin e auditorit dhe nuk i takon entitetit të gjykoj se çfarë ne duhet ta konsiderojmë materiale e çka jo, sepse sipas gjykimit të tyre shihet se asgjë në raport nuk është materiale. Kjo ka qenë arsyeja kryesore e komenteve të menaxhmentit të ndërmarrjes në pjesën me të madhe të raportit.

Kompensimi i llogarive në mes Telekomit dhe Radio Televizionit të Kosovës	Nuk pajtohem - Thyerja e kërkesave dhe obligimeve është bërë në përputhje me IAS 32. Telekomit dhe RTK kanë kontrata të veçanta për ofrim të shërbimeve ndaj njëra tjetrës. Ne kemi njohur të hyra dhe llogari të arkëtueshme për shërbime që RTK ka marrë nga Telekomit, ashtu siç kemi njohur shpenzime dhe detyrime për shërbimet që kemi marrë nga RTK. Në vitin 2019 palët kanë njohur obligimet reciproke dhe kemi arrit marrëveshje që për një pjesë të borxheve dhe obligimeve të bëhen thyerje. Marrëveshja është e formalizuar. Kjo praktikë e thyerjes së të arkëtueshmeve dhe obligimeve pasi që të njëjtat janë njohur fillimisht, nuk ndikon në prezantim të drejtë të pasqyrave financiare. Një praktikë të tillë e aplikojmë edhe me kompani tjera vazhdimisht.	Sipas SNK 1, Kompensimi pika 32. Aktivitet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk duhet të kompensohen me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një Standard ose një Interpretim, dhe pika 33. Është e rëndësishme që aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të raportohen veçmas. Kompensimi në pasqyrën e të ardhurave ose në bilanc, me përjashtim të rastit kur kompensimi reflekton thelbin e transaksionit ose një ngjarjeje tjetër, pakëson aftësinë e përdoruesve për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera që kanë ndodhur dhe për të vlerësuar flukset e ardhshme monetare të njësisë ekonomike. Për më shumë, në kornizën tonë kombëtare të raportimit, as me SKK, as me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, dhe me asnjë rregullore tjetër, kjo nuk është lejuar. Thyerja e saldove apo netimi i llogarive aplikohet nga bankat të cilat kryejnë qindra apo edhe mijëra transaksione gjatë ditës, dhe duke qenë i pamundur një numër kaq i madh transferesh, çdo ditë bëjnë thyerjen e gjendjes së llogarive. Por, kjo është e lejuar me Rregulloren të veçanta të Bankave Qendrore apo një rregullatori tjetër, por jo në të gjitha rastet.
--	---	--

Mos zbritja e pagesave të konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara	Nuk pajtohem - Kjo çështje nuk ndikon në mos prezantim të saktë llogarive të arkëtueshme në Pasqyra Financiare. Në pasqyra financiare nuk prezantohen saldot individuale të secilit klientë, por saldot e klientëve në tërësi. Për shkak të numrit të madhë të transaksioneve dhe faktit që disa klientë me rastin e kryerjes së pagesave në bankë nuk paraqesin informacione të mjaftueshme për të identifikuar se për cilin klient ose shërbim bëhet fjalë, disa pagesa të arkëtuara kemi vështirësi të identifikojmë dhe që atyre klientëve të u zvogëlohet gjendja e borxhit. Këto mjete mbahen në një llogari të përkohshme si “mjete të paalokuara” dhe vazhdimisht punohet në identifikimin e tyre dhe pas identifikimit këto mjete barten tek klienti i cili ka bërë pagesën. Pasi që këto arkëtime realisht konsiderohen arkëtime të llogarive të arkëtueshme por që s’kemi mundur të i identifikojmë se për cilin debitor bëhet fjalë, këto arkëtime ndikojnë në zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Prandaj, kjo nuk ndikon në prezantim të saktë të llogarive të arkëtueshme në Pasqyra Financiare.	Gjetja qëndron për faktin se ndërmarrja nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikim të klientëve, mjetet monetare të të cilëve janë regjistruar në këto llogari dhe të zbriten obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes.
Normat e zhvlerësimit jo në harmoni me rregullat e brendshme	Nuk Pajtohem - zhvlerësimi bëhet sipas Plotësimi me Annex tek MPK 3 -Manualit të Politikave Kontabël - Asetet. Zhvlerësimi bëhet në bazë të specifikave të secilit aset. Jo domosdoshmëritë aseti i njëjtë mund të zhvlerësohet me normë të njëjtë, sidomos kjo ndodh tek disa asete që janë te vendosura në prona me qira.	Komenti juaj sërish është i pasaktë dhe gjetja nuk ndryshon, sepse aplikimi i normave të ndryshme të zhvlerësimit për pasuri të njëjta, ndikon në keq deklarim të vlerës neto të pasurive në bilancin e gjendjes dhe të shpenzimeve të zhvlerësimit në pasqyrën e të ardhurave. Përveç kësaj, normat e zhvlerësimit ishin në kundërshtim me manualin e politikave kontabël të ndërmarrjes. Nuk ka politika të zhvlerësimit specifike për secilin pasuri. Pasuritë grupohen dhe normat e zhvlerësimit përcaktohen për grupin, por jo për secilën pasuri veç e veç.

Prezantim jo i drejtë i pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet	Nuk Pajtohem - lidhet me çështjet me të cilat nuk pajtohem	E gjetura qëndron. Menaxhmenti i ndërmarrjes nuk ka paraqitur arsye konkrete lidhur me mospajtimin e tyre për këtë çështje.
Prezantimi i pasaktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë	Nuk Pajtohem - lidhet me çështjet me të cilat nuk pajtohem	Njëjtë si komenti sipër.



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
PRITITELI / APPOINTED:		27.06.2022	
Emri Org.	Shtetësi	Mr. Prot.	Mr. Prot.
Org. Unit.	Klasif. Kod	Prot. No.	Str. Stranica
05	47	1111	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjes "Telekomi i Kosovës" sh.a. për vitin 2021 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me të gjeturat dhe rekomandimet, për të gjeturat të cilat nuk pajtohem në përmbajtjen e Raportit kemi dërguar komente; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Shpëtim Dobra

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve,

Data: 24. Qershor 2022, Prishtinë,

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ³ Vlen të ceket se këto pasuri ishin regjistruar në regjistrin e pasurive për gjatë viteve 2011 deri në 2018.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Pasqyrat Financiare (të paaudituar) për
periudhën që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimit në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parase	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7-40


TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2021

(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor (i ri-shikuar) 2020
ASETET			
Asetet e patrupëzuara	6	11,914	15,027
Prona, impiantet dhe pajisjet	7	22,666	28,834
E drejta e shfrytëzimit të aseteve	7	7,673	11,900
Asetet financiare të disponueshme për shitje	8	2	2
Pasuria e tatimit të shtyrë	9	1,234	1,410
Gjithsej asetet jo-qarkulluese		43,489	57,173
Asetet qarkulluese			
Stoqet	10	2,788	2,949
Shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshme tjera afatshkurtëra	11	849	1,056
Të arkëtueshmet tregtare	12	3,153	3,455
Të arkëtueshmet e tatimit mbi të ardhurat	23	5	5
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	13	10,953	117
Gjithsej asetet qarkulluese		17,748	7,582
GJITHSEJ ASETET		61,237	64,755
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali i emetuar	14	4,475	4,475
Komponente tjera të kapitalit	14	55,000	55,000
Humbjet e akumuluar		(76,264)	(80,435)
Gjithsej ekuiteti		(16,789)	(20,960)
Detyrimet			
Detyrimet-e drejta e shfrytëzimit	16.1	7,673	11,900
Gjithsej detyrimet jo-qarkulluese		7,673	11,900
Detyrimet qarkulluese			
Provizionet	15.1	25,303	22,350
Të pagueshmet tjera dhe akrualet	15.2	22,542	15,858
Të pagueshmet tregtare	16	15,579	16,307
Të hyrat e shtyra	17	6,025	4,299
Dividentët e pagueshme	14	-	15,000
Tatimi i pagueshëm		904	-
Gjithsej detyrimet jo-qarkulluese		70,353	73,815
Gjithsej detyrimet		78,026	85,714
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		61,237	64,755

Autorizuar për publikim nga menaxhmenti më 21 Prill 2022, të nënshkruara në emër të tyre:


Burbuqe Hana UD i KE




Fejm Kelmendi UD i ZKFTH

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

	Shënim	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020 (i ri-shikuar)
Të hyrat	18	50,541	51,158
Të hyrat tjera	19	8,362	258
Shpenzimet operacionale	20	(12,490)	(11,568)
Shpenzimet e stafit	21	(23,559)	(26,227)
Zhvlerësimi	7	(6,729)	(9,018)
Amortizimi	6	(3,113)	(3,678)
Shpenzimet tjera operative	22	(18,537)	(14,268)
Humbja Operative		<u>(5,525)</u>	<u>(13,343)</u>
Zhvlerësimi i të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë		(4,570)	(4,726)
Interesi për të drejtën e shfrytëzimit		(558)	(900)
Humbja përpara tatimit		<u>(10,653)</u>	<u>(18,969)</u>
Shpenzimet Tatimore	23	(176)	242
Neto Humbja për vitin		<u>(10,829)</u>	<u>(18,727)</u>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		<u>(10,829)</u>	<u>(18,727)</u>
Humbja që i atribuohet pronarëve		<u>(10,829)</u>	<u>(18,727)</u>
Gjithsej humbja gjithëpërfshirëse që i atribuohen pronarëve		<u>(10,829)</u>	<u>(18,727)</u>

Shënimet përcjellëse nga 1 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumatat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

	Shënimi	Kapitali i Emetuar	Komponente tjera të kapitalit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2021		4,475	55,000	(80,435)	(20,960)
Të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin					
Humbja për vitin				(10,829)	(10,829)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse				15,000	15,000
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin				4,171	4,171
Transaksionet me pronarët					
Dividendat e deklaruar	14	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët		-	-	-	-
Bilanci me 31 Dhjetor 2021		4,475	55,000	(76,264)	(16,789)
Bilanci më 1 janar 2020		4,475	55,000	(66,273)	(6,798)
Ndryshimet në ekuitet				4,565	4,565
Të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin					
Fitimi për vitin		-	-	(18,727)	(18,727)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse					
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse				(18,727)	(18,727)
Transaksionet me pronarët					
Dividendet paguara	14	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me aksionarët		-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2020		4,475	55,000	(80,435)	(20,960)

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Pasqyra e Rrjedhjës së Parasë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021 (të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

Shënim	Për fund periudhën 31 Dhjetor 2021	Për fund periudhën 31 Dhjetor 2020 (i ri-shikuar)
Aktivitetet operative		
Humbja para tatimit	(10,653)	(18,727)
Rregulluar për:		
Ndryshimi në ekuitet	15,000	4,565
Zhvlerësimin	7 6,729	9,018
Amortizimin	6 3,113	3,678
Humbjet e dëmtimit në vlerë në borxhet e dyshimta	11 (677)	(1,464)
Humbje nga zhvlerësimi i aseteve financiare	8 -	-
Shpenzimi (e hyra) i tatimit të shtyrë	23 176	-
Interesi për të drejtën e shfrytëzimit	-	-
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	-	(242)
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues dhe provizione	13,688	(3,172)
Ndryshimet në stoke	10 160	1,524
Ndryshimet në të arkëtueshmet tregtare	11 979	(1,215)
Ndryshimet në shpenzimet e parapaguara, të arkëtueshmet tjera dhe tatimet	12 208	566
Ndryshimet në të pagueshmet tregtare	16 (728)	3,820
Ndryshimet në provizione	15.1 2,952	(2,320)
Ndryshimet në akruale dhe të pagueshme tjera	15.2 6,684	(136)
Ndryshimet në të hyrat e shtyra	17 1,550	1,047
Ndryshimet në obligimet për drejtën e shfrytëzimit	(4,226)	(5,359)
Paraja e gjeneruar nga operimet	21,267	(4,973)
Tatimi mbi të ardhura i paguar	23 903	-
Paraja neto nga aktivitetet operative	22,170	(4,973)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive		
Pagesat për blerjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve	7 (560)	(560)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investive	(560)	(560)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Dividenda	(15,000)	
E drejta e shfrytëzimit	4,226	5,360
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese	(10,774)	5,360
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë	10,836	(174)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	13 117	291
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	13 10,953	117

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

1 HYRJE

1.1 Informata të përgjithshme

Telekomi i Kosovës Sh.A është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 100% të aksioneve të Telekomit të Kosovës. Selia kryesore e Kompanisë është e vendosur në Dardani, Prishtinë, Republika e Kosovës

Aktivitetet e biznesit të Kompanisë përbëjnë ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit, të telefonisë mobile dhe telefonisë fikse, internetit dhe televizionit përmes protokollit IPTV.

Më 31 dhjetor 2021 Kompania ka 2,209 të punësuar (31 Dhjetor 2020: 2,288).

Më 1 gusht 2012 me vendim të Qeverisë së Kosovës, shërbimet postare janë transferuar në Postën e Kosovës një kompani e re e formuar, ku 926 punonjës lënë Kompaninë.

Në bazë të vendimit të Bordit dhe aprovimit nga Aksionari me datën: 22 korrik 2015 Kompania ndryshoi emrin e saj ligjor nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A në Telekom i Kosovës Sh.A. Emri i ri ligjor është përditësuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës më 12 gusht 2015.

Në mënyrë që pasqyrat financiare të jenë më të kuptueshme, emri i mëparshëm i Kompanisë do të përdoret kur është e nevojshme.

1.2 Informata mbi operimin e kompanisë

Telekomi i Kosovës Sh.A. (TK) përpara Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) ka qenë një ndërmarrje sipas kuptimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 "Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit". Rregullorja 2005/18 i ka dhënë AKM-së autoritetin për të transformuar ndërmarrjet në korporata. Në takimin e datës 9 maj 2005, Bordi i Drejtorëve i AKM-së ka vendosur të transformojë ndërmarrjen PTK në shoqëri aksionare, të quajtur Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.A. Në datën e korporatizimit më 22 qershor 2005, PTK holding në mënyrë efektive zëvendëson "ndërmarrjen" e mëparshme që kryente biznes në mënyrë formale si "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës" në baza vazhdimësie, pa likuidim. Ndërmarrja PTK është ndërmarrja e parë që është transformuar në Korporatë nën rregulloren e AKM-së dhe Udhëzimin Administrativ 2005/6. AKM-ja, që vepron si administrator i besuar për pronarët kryesor të ndërmarrjeve të Kosovës bazuar në rregulloren e AKM-së, është aksionari aktual i 100% të aksioneve të PTK Holding. Kapitali i emetuar aksionar në korporatizim shënon 260 milionë Euro. Menjëherë pas korporatizimit, PTK Holding ka formuar një grup operativ, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A. ("PTK") dhe ka transferuar disa nga pasuritë e saj tek PTK në formë të kontributit kapital. PTK Holding ka në pronësi 100% të PTK-së.

Kapitali i regjistruar i degës në pronësi të plotë është 250 milionë Euro, dhe aksionet e degës janë emetuar në këmbim për asetet eaktuara neto të kontribuar nga PTK Holding. Duke pasur parasysh efektin praktik të transformimit dhe korporatizimit, Administrata Tatimore ka aprovuar procesin ristrukturues të ndërmarrjes PTK si një "riorganizim" për qëllime të Nenit 24.1. të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave".

Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Ndërmarrjet Publike (ligji Nr. 03/L-087), dhe në bazë të dispozitave të nenit 3 të këtij ligji, ndërmarrjet qendrore në pronësi publike, duke përfshirë PTK Sh.A., janë deklaruar si pasuri e Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e aksionarëve mbi Ndërmarrjet Publike.

1 HYRJE (VAZHDIM)

1.3 Aktivitetet biznesore, natyra e operimit të kompanisë

Më 31 Dhjetor 2021, Telekom i Kosovës është e regjistruar në Regjimin e Ndërmarrjeve për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjetit publik fiks dhe mobil në nivel nacional.

Shërbimet publike të komunikimeve elektronike përfshijnë, ofrimi i shërbimeve publike fikse telefonike (lokale, nacionale, ndërkombëtare, si dhe telefona publik me pagesë), ofrimi i shërbimeve publike mobile (transmetim të zërit dhe të dhënash), ofrimi i shërbimeve të linjave me qira (Fibër optik të pa-ndrikuar dhe linja të tjea me qira), ofrimi i shërbimeve të Internetit në nivel nacional dhe ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), ka autorizuar dhe ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezin 900MHz dhe 1800MHz, për shfrytëzim efektiv komercial për periudhën 20 vjeçare me fillim nga data: 31 Korrik 2019 deri më 30 Korrik 2039 dhe i është lejuar mundësi e pagesës me dhjetë (10) kështe vjetore të çmimit "one-off" duke përfshirë edhe normën e interesit.

Në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës, duke filluar nga 1 Gushti 2012 Posta e Kosovës operon si njësi biznesi e veçantë nga PTK-ja. Procesi i ndarjes së Postës së Kosovës ka filluar në fillim të vitit 2012 në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 16/53 të datës: 21 Dhjetor 2011 mbi ndarjen e Postës së Kosovës. Kjo ndarje është bërë në përputhje me raportin e këshilltarit të pavarur e muajit Korrik 2011, i cili pastaj u aprovua nga menaxhmenti i PTK-së.

Ndërmarrja e PTK-së në vitin 2000 arriti një marrëveshje me "Monaco Telecom International" ("MTI") për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë ku kjo marrëveshje i jep të drejtë PTK-së të përdorë kodin ndërkombëtar të MTI-së, i cili i mundëson rrjetit mobil të PTK-së lidhje me rrjetet ndërkombëtare. Si element i kësaj marrëveshjeje, PTK-ja i kompenson MTI-së një pjesë të të hyrave dhe pagesë të disa shpenzimeve të trafikut ndërkombëtar. Gjatë vitit 2006, kontrata ndërmjet MTI dhe PTK Sh.A. ishte ri-negociuar dhe ndryshuar. Kontrata e re kornizë përfshin përdorimin e kodit të thirrjeve të Monaco International, trafikun ndërkombëtar, roaming dhe transferimin e njohurive teknike, e cila marrëveshje hyn në fuqi më 1 Janar 2010. Përveç kësaj, kontrata kornizë përfshinte edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve. Gjithashtu, në maj të vitit 2009, kontrata ndërmjet MTI dhe PTK Sh.A. ishte ri-negociuar dhe ndryshuar. Aneksi i kontratës së re kornizë përfshin përdorimin e kodit të thirrjeve të Monaco Internacional, trafikun ndërkombëtar, roaming dhe transferimin e njohurive teknike, e cila ka hyrë në fuqi nga 1 Janari 2010.

Përveç kësaj, Aneksi i kontratës së re kornizë përfshin edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve si dhe zvogëlim të tarifave për kodin. Përveç kësaj, Aneksi i kontratës së re kornizë përfshin edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve si dhe zvogëlim të tarifave për kodin.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA

2.1 Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB). Ndikimi i aplikimit të SNRF-ve do të shpaloset në shënimet sçaruese nëse pas aplikimit të tyre nga kompania do të ketë efekt në pasqyrat financiare.

Një numër i standardeve të reja që janë lëshuar nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, interpretime dhe amendamente të lëshuara nga Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) janë efektive për periudha që fillon nga (ose pas) 1 Janari 2021.

2.2 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën nga (ose pas) 1 Janari 2021

Ekzistojnë një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në këtë periudhë të kontabilitetit.

Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë nga (ose pas) 1 Janari 2021 edhe pse janë efektive nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të kompanisë. Këto ndryshime do të paqesim me poshtë:

1. Ndryshimet në SNRF 4 - një përjashtim i përkohshëm opsional nga zbatimi i SNRF 9 për njësitë ekonomike veprimtaria mbizotëruese e të cilave është lëshimi i kontratave brenda objektit të SNRF 4. Hyn në fuqi për herë të parë nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit.
2. Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit: Përkufizimi i një biznesi, lëshuar nga 2018 dhe efektive vitin e raportimit.
3. Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7, SNRF 4 Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit - efektive për periudhën e raportimit. Ndryshimet e Fazës 2 ofrojnë lehtësime të përkohshme që trajtojnë efektet e raportimit financiar kur një normë e ofruar ndërbankare ("IBOR") zëvendësohet me një normë Interesi alternative pothuajse pa rrezik ("RFR").
4. Ndryshim në SNRF 16 Lizingu: Koncesione Lizingu të lidhura me COVID-19- zbatohet në praktike vetëm në rastet e koncesioneve të qirave që ndodhin si pasojë e drejtëpërdrejtë e pandemisë COVID-19. Kompania nuk ka negociuar ndonjë marrëveshje qiraje si rezultat i COVID-19 dhe nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare.

Shënim: jo të gjitha standardet dhe interpretimet e reja që kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhën nga (ose pas) 1 Janari 2021 kanë efekt në pasqyrat financiare të kompanisë.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

2.3 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet e publikuara por jo të zbatueshme gjatë 2021

Standardet dhe interpretimet e publikuara nga BSNK/IASB, por ende jo të zbatueshme për periudhën vjetore që fillon më 1 janar 2021 dhe përfundon më 31 dhjetor 2021 janë:

Standardet, amendamentet dhe interpretimet

Ndryshimet në SNK 16 Prona, Impiantet dhe Pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar ndalon një njësi ekonomike të zbres nga kostojat e aktivitetit çdo të ardhur të marrë nga shitja e artikujve të prodhuar derisa njësi ekonomike është duke përgatitur aktivin për përdorimin e tij të synuar. Të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë, së bashku me kostot e prodhimit do të njihen në fitim ose humbje. Kostoja nuk do të përfshijë amortizimin e aktivitetit që testohet sepse nuk është gati për përdorimin e tij të synuar. 1 Janar 2022

Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Pasuritë dhe Detyrimet Kontigjente: Kontratat e mëdha - Kostoja e Përmbyshjes së Kontratës - sqaron kuptimin e kostove për të përmbyshur një kontratë. Kostoja direkte e përmbyshjes së një kontrate përfshin kostot rritese të asaj kontrate, dhe alokimi i kostove tjera që lidhen drejtëpërdrejt me përmbyshjen. Ndryshimi sqaron gjithashtu se para se të krijohet një provizion i veçantë për një kontratë, njësi ekonomike duhet të njeh çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur në aktivet e përdorura në përmbyshjen e kontratës, jo vetëm për asetet e dedikuara në atë kontratë. 1 Janar 2022

Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit u ndryshua për t'iu referuar Kornizës Konceptuale 2018 për Raportim Financiar, për të përcaktuar se çka përbën një aktiv ose një pasiv në një kombinim biznesi. - 1 Janar 2022

Ndryshimet në SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata - Këto ndryshime sqarojnë se detyrimet klasifikohen si afatshurtëra ose afatgjata në varësi të të drejtave që ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit. Detyrimet janë afatgjata nëse njësi ekonomike ka një të drejtë thelbësore në fund të periudhës së raportimit, të mos ketë shlyerje për të paktën edhe një vit. Detyrimet afatshkurta konsiderohen nëse kushtet prishen para ose në datën e raportimit. 1 Janar 2023

Ndryshimet në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës së SNRF-ve - Shpalosja e Politikave të Kontabilitetit 1 Janar 2023

Ndryshimet në SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"; 1 Janar 2023

Ndryshimet në SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve të Kontabilitetit 1 Janar 2023

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

Politikat kryesore kontabël të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse nuk shprehet ndryshe.

3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

3.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazën e matjes të specifikuar nga SNRF për çdo lloj pasurie, detyrimi, të ardhure dhe shpenzimi. Baza e matjes është përshkruar në politikat kontabël më poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është bërë në përputhje me SNRF që kërkon përdorimin e vlerësimeve kritike kontabël. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në: Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim.

3.3 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të hipotezës së vijimësisë që supozon se Kompania do të jetë në gjendje të mbledh të arketueshmet e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj brenda rrjedhës normale të aktivitetit biznesor. Si të tilla, këto pasqyra financiare nuk pasqyrojnë rregullimet dhe riklasifikimet e mundshme të pasurive dhe detyrimeve të cilat do të kërkojnë në rast se Kompania nuk do të jetë në gjendje të vazhdojë me aktivitetet e saja të biznesit si një vazhdimësi.

Kompania ka pësuar humbje për vitin që ka përfunduar 31 Dhjetor 2021 në vlerë prej 10,832 mijë Euro (2020: 18,727 mijë Euro), humbjet e akumuluar janë në vlerë prej 76,267 mijë Euro. Përveç kësaj, më 31 Dhjetor 2021 detyrimet rrjedhëse tejkalojnë pasuritë aktuale për shumën prej 52,605 mijë Euro (2020: 66,233 mijë Euro).

Për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve në vitin 2021 menaxhmenti ka ndërmarrë disa veprime të cilat u përgjigjen direkt këtyre kërcënimeve duke vlerësuar dhe vërtetuar të gjitha kostot e shpenzimeve ku mund të bëhen reduktimet.

Gjatë vitit 2021, janë ndërmarrë këto veprime:

Në përgjithësi borxhet ndaj kreditorëve më të vegjël janë ulur ndjeshëm dhe nuk përmballemi me ndonjë rrezik të vecantë që do të rrezikonte parimin e vijimësisë.

Në kuadër të zbatimit të "Pakos së Ringjalljes Ekonomike për masën 4.6 - Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike", Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim, nr. 01/53 datë: 31.12.2021 për mbështetje të kërkesës së Telekomit të Kosovës prej 10 milion Euro, për mbulimin e obligimeve financiare ndaj Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), përndryshe rrezikohej marrja e licencës së Telekomit të Kosovës dhe siguria e operimit të infrastrukturës kritike.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.3 Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Në fund të vitit 2021 me kërkesë të Menaxhmentit të Telekomit dhe Bordit të Drejtorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 02/53 të datës 31.12.2021, vendos për shfuqizimin e pjesshëm të Vendimit të Qeverisë Nr. 17/20 si dhe shlyerjen e vlerës prej 15 milion Euro të dividendës së kërkuar.

Me datë 15/12/2021 Gjykata Kushtetuese ka aprovuar kërkesën e Telekomit shkeljet në procedurat përmbarimin me rastin Dardafon nga të tri shkallët e Gjykatave (Themelore, Apelit dhe Supreme), rastin është kthyer në Gjykatën e Apelit dhe sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Apelit deri me 15 Mars 2022 duhet të marrë vendim për rigjykim të rastit ose rikthimin e rastit në Gjykatën Themelore. Pritjet tona janë që gjatë një procesi të drejtë gjyqësor borxhi ndaj Dardafon të zbritet ndjeshëm për disa milion €, gjë e cila do ta lehtësonte gjendjen financiare të Telekom.

Gjatë vitit 2021 aksionarit ia kemi sqaruar në detaje problemet me të cilat ballafaqohet Telekom si dhe potencialet për zhvillim të Telekom pas tejkalimit të gjendjes së krijuar. Aksionari pasi ka kuptuar drejtë gjendjen aktuale dhe potencial për zhvillim të Telekomit në buxhetin e vitit 2022ka ndarë 40 milion € për dy ndërmarrje Publike njëra nga të cilat është Telekom.

Pas marrjes së këtij zotimi me njëherë kemi hapir procedurat e tenderimit për tri projekte kapitale të rëndësi të vecant për Telekomin (implementimin e kodit shtetor, zgjerimin e rrjetit të telekomise mobile, investimin në sisteme të brendshme që ndihmojnë funksionimin e përgjithshëm të operimeve të Telekomit.

Pas implementimit të këtyre projekteve, do të kursehen rreth 1.5 milion € në viti (kodi shtetëror), do të përmirësohet ndjeshëm cilësia e shërbimeve që do të ndikon në rritjen e të hyrave etj.

Poashtu, jemi në kontakt me aksionarin për financimin e pakos dalëse për pensionimin të parakohshëm të punëtorëve (pas rstrukturimit), kjo do të ulte ndjeshëm shpenzimet e pagave në vitet e ardhshme dhe do të lehtëson barrën financiare të kompanisë.

Sfidat kryesore nga aspekti pamundësisë së pagesës së obligimeve të cilat do të mund ta cenonin seriozisht parimin e vijimësisë janë pbligimet ndaj Adimistratës Tatimore.

Poashtu në Shkurt të vitit 2022 kemi pranuar Vendimin e Arbitrazhit II me Rastin Dardafon, ky vendim është i pavaforshëm për Telekomin dhe sipas tij Telekom obligohet të paguaj rreth 13 milion € (përshire kamatat). Telekom do të shfrytëzojë të gjitha rrugët ligjore për të ankimuar këtë vendim. Pritjet tona janë që ky vendim në rastin më të keq për Telekomin nuk mund të zbatohet gjatë vitit 2022.

Jemi të vetëdijshëm që këto masa nuk janë plotësisht të mjaftueshme për t'u përballur me të gjitha detyrimet që Telekom i Kosovës Sh.A. ka ndaj kreditorëve dhe nuk e shmangin plotësisht rrezikun që këto detyrime kërcënojnë seriozisht parimin e vijimësisë.

Kemi analizuar mundësitë reale financiare që ka Telekom i Kosovës Sh.A. në bazë të projeksioneve financiare dhe në bazë të tyre kemi përgatitur një strategji për përballjen me këto detyrime.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.4 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në euro, që është monedha/valuta funksionale e kompanisë. Të gjitha informatat financiare të raportuara në euro, janë rumbullakuar në mijëshen më të përafërt, vetëm në rastet që paraqitet ndryshe.

3.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave të kontabilitetit dhe shumat e raportuara të aseteve, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë rishikuar vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në ndonjë periudhë pasuese që preket nga ato.

Veçanërisht, informacioni mbi fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit që kanë ndikimin më të madh në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 5 në Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit ku bëjnë pjesë:

- *Rikuperimi i llogarive dhe depozitave bankare*
- *Jetëgjatësia e pasurive*
- *Stoqet*
- *Rikuperimi i llogarive të arkëtueshme*

3.6 Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit

COVID-19: Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë, dhe globalisht, mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat kërkojnë rregullime materiale të vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, menaxhmenti pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e pasurive të patrupëzuara, pronës dhe pajisjeve, pasurive me të drejtë përdorimi, llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme tjera, huamarrjeve, llogarive të pagueshme dhe të pagueshme tjera dhe vlerës së tyre bartëse mund të kërkoj korrigjim. Mirëpo, në këtë fazë menaxhmenti nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po rrjedhin dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ketë ndikim edhe në të ardhurat, flukset e parave dhe profitabilitetin.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**3.7 Valuta e huaj**

Transaksionet në valutë të huaj janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit që është në datat e transaksioneve. Asetet monetare dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit janë kthyer përsëri në valutën funksionale me normën e këmbimit në atë datë. Fitimi dhe humbja e valutës së huaj mbi zërat monetar është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutën e huaj të kthyer në normën e këmbimit në fund të periudhës. Asetet jo-monetare dhe detyrimet në valuta të huaja që janë matur në vlerë reale janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera reale. Ndryshimet e valutës së huaj që dalin nga kthimet janë njohur në fitim apo humbje, përveç për diferencat që dalin nga rikthimi i instrumenteve të ekuitetit të gatshme për shitje (nëse ka).

3.8 Pasuritë e patrupëzuara*(i) Njohja dhe matja*

Asetet e patrupëzuara janë matur në kosto, minus amortizimi i akumuluar dhe dëmtimi i akumuluar në vlerë, nëse ka.

(ii) Shpenzimet pasuese

Shpenzimi pasues është kapitalizuar vetëm kur rritë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në asetin specifik me të cilin ndërlidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe brendet e gjeneruar në mënyrë interne, është njohur në fitim dhe humbje kur ka ndodhur.

(ii) Amortizimi

Amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të metodës drejtvizore përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit të aseteve të patrupëzuara nga data kur ato janë të gatshme për përdorim. Kohëzgjatjet e vlerësuar të përdorimit janë në vazhdim (për vitin 2021 dhe 2020):

• Programet kompjuterike	1-20 vite
• Licencat e telekomit	4-20 vite

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.9 Prona, impiantet dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë matur në kosto (ose kosto të vlerësuar), minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë. Kostoja e gjykuar paraqet koston e rivlerësuar të disa zërave të pronës, impianteve dhe pajisjeve që janë rivlerësuar më 1 janar 2005, datë e kalimit tek SNRF-të, me vlerë reale në lidhje me korporatizimin e filluar të PTK Holding.

Kostoja përfshin shpenzimet që janë direkt të ngarkuara në blerje të asetit. Kostoja e aseteve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që është direkt e ngarkuar në sjelljen e asetit në gjendje pune për qëllimin e menduar, dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së artikullit dhe rregullimin e vendit ku janë vendosur. Shpenzimet kapitale mbi asetet gjatë ndërtimit janë bartur tek Asetet në ndërtim dhe janë kapitalizuar e transferuar në kategorinë e duhur të asetit atëherë kur përfundohen, prej ku fillon aplikimi i zhvlerësimit në normën e aplikueshme ndaj kategorisë në fjalë.

Kur pjesët e një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve kanë kohë të ndryshme të përdorimit, ato janë regjistruar si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

(ii) Kostot pasuese

Kostoja e pjesëve zëvendësuese të një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve njihet në vlerën bartëse të zërit nëse është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tyre të mund të matet me besueshmëri. Kostot e serviseve të përditshme të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kur kanë ndodhur. Fitimet apo humbjet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë përcaktuar duke u referuar në vlerën e tyre bartëse dhe janë marrë parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të metodës drejtvizore përgjatë kohës së vlerësuar të përdorimit të secilës pjesë të një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Toka dhe pasuritë në ndërtim nuk janë zhvlerësuar. Kohët e vlerësuar të përdorimit për klasat madhore të aseteve janë si në vazhdim (si për vitin 2021 edhe 2020):

• Ndërtesat (nga data e vlerësimit), Bazamente për BTS, shtëpliza për gjenerator	20 vite
• Zyrat postare (strukturë druri)	10 vite
• Linjat e rrjetit dhe kablli optik	5-20 vite
• Kanalet kablloviqe dhe shtyllat e antenave	5-20 vite
• Stacionet Bazë/BTS	3-5 vite
• Makineria dhe pajisjet	1 deri 10

Kohëzgjatja e përdorimit, metodat e zhvlerësimit dhe vlerat e mbetura, nëse kanë qenë të rëndësishme, të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë rivlerësuar në datën e raportimit.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**3.10 Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare**

Prona, ndërtesat e pajisjet, si dhe asetet e patrupëzuara, janë shqyrtuar për rënie në vlerë sa herë që ngjarje të ndryshmeve, në rrethana të caktuara, tregojnë se shuma bartëse e një pasurie nuk mund të jetë e rikuperueshme. Kurdo që shuma bartëse e një pasurie e tejkalon shumën e vet të rikuperueshme, humbjet nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Shuma e rikuperueshme është më e lartë se çmimi neto i shitjes së një pasurie dhe vlerës në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e arritshme nga shitja e një pasurie në transaksion të plotë, ndërsa vlera në përdorim është vlera aktuale e fluksit të parave të gatshme e parashikuar në të ardhmen që pritët të rrjedhin nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe heqja e saj në fund të përdorimit. Shumat e rikuperueshme janë llogaritur për aset individual, ose, nëse nuk është e mundur, për njësinë që gjeneron para të gatshme.

3.11 Pasuritë financiare

Kompania klasifikon asetet saj financiare në kategoritë e mëposhtme: huatë dhe të arkëtueshmet dhe në asete financiare në dispozicion për shitje. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo të prejardhura, me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të maturimeve më të mëdha se 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare. Huatë dhe të arkëtueshmet e kompanisë, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, depozitat afatshkurtra në bankë si dhe para dhe ekuivalentët e parasë.

Pasuritë financiare të gatshme për shitje

Pasuritë financiare të gatshme për shitje janë jo-derivative që janë ose të përcaktuara në këtë kategori ose nuk klasifikohen në asnjërën prej kategorive tjera. Ato janë të përfshira në pasuritë jo-qarkulluese përveç kur menaxhmenti synon t'i heqë investimin brenda 12 muajve nga data e pasqyrave të pozicionit financiar.

Njohja dhe matja

Blerja dhe shitja e pasurive financiare njihen në datën e tregtisë - data në të cilën Kompania bën blerjen apo shitjen e pasurisë.

Të gjitha pasuritë financiare, përveç pasurive në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit.

Të gjitha aktivet financiare, përveç pasurive në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlerën e transaksionit plus kostot me vlerën e drejtë. Aktivet financiare çregjistrohen kur e drejta për të marrë flukset e mjeteve monetare nga investimet kanë skaduar apo janë transferuar dhe kompania ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**3.11 Pasuritë financiare (vazhdim)**

Pasuritë financiare të gatshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë monetare të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në kapitalin neto.

Kur letrat me vlerë të klasifikuara si në dispozicion për shitje janë shitur ose kanë rënë në vlerë, rregullimet në vlerën e drejtë të akumuluar të njohura në ekuitet janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme si fitime dhe humbje nga letrat me vlerë të investimeve.

Interesi në letrat me vlerë që janë në dispozicion për shitje, i llogaritur duke përdorur metodën efektive të interesit, njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividendët për instrumentet e kapitalit në dispozicion për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme si pjesë e të ardhurave të tjera, kur është themeluar e drejta e Kompanisë për të marrë pagesat.

Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar janë të bazuara në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një aset financiar nuk është aktiv (dhe për letrat me vlerë jo të listuara), Kompania vendos vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Humbja në vlerë e pasurive financiare

Kompania vlerëson në çdo datë raportimi, nëse ka evidencë objektive, nëse një pasuri financiare ose grup pasurish financiare janë zhvlerësuar. Një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare janë zhvlerësuar dhe humbjet nga zhvlerësimi ndodhin vetëm nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë (një "rast humbjeje") dhe në këtë rast humbja (ose rastet) ka një ndikim në rrjedhën e ardhshme të parasë të vlerësuar të pasurisë financiare ose grupi i pasurive financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Evidenca e zhvlerësimit mund të përfshijë tregues se debitorët ose një grup i debitorëve është duke përjetuar vështirësi të konsiderueshme financiare, mos pagesa në interes apo pagesat e principalit, mundësi që ata do të hyjnë në procesin e falimentimit ose riorganizime të tjera financiare, si dhe në rastet ku të dhëna të dukshme tregojnë se ka një rënie të matshme në rrjedhën e ardhshme të parasë së vlerësuar, të tilla si ndryshimet në borxh ose kushte ekonomike që lidhen me standarde.

Pasuritë e mbajtura me koston e amortizuar

Për kredi dhe kategorinë e të arkëtueshmeve, humbja matet si diferencë midis vlerës kontabël të pasurisë dhe vlerës aktuale të rrjedhës së ardhshme të parasë së vlerësuar (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur) skontuar me normën fillestare të pasurisë financiare të interesit efektiv. Pasuritë me maturim të shkurtër nuk janë vlerësuar dhe vlera e tyre nuk është zbritur. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Nëse një kredi apo investim që mbahet deri në maturim ka një normë interesi të ndryshueshme, norma e skontimit për matjen e çdo humbje nga zhvlerësimi është norma aktuale e interesit efektiv e përcaktuar sipas kontratës. Si një zgjidhje praktike, Kompania mund të matë zhvlerësimin në bazë të vlerës së drejtë të një instrumenti duke përdorur një çmim tregu të vëzhguar.

Në qoftë se, në një periudhë të mëpasshme, shuma e humbjes nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (të tilla si një përmirësim në vlerësimin e kreditit të debitorit), anulimit të humbjes nga zhvlerësimi, të njohur më parë, njihet në pasqyrën e të ardhurave. Testimi për zhvlerësim i të arkëtueshmeve tregtare është përshkruar në këtë Shënim 3.10.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.11 Pasuritë financiare (vazhdim)

Pasuritë e gatshme për shitje

Në rast të investimeve të gatshme për shitje, rënia e ndjeshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të pasurive nën koston e tyre është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë zhvlerësuar. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston, për pasuritë financiare të gatshme për shitje, humbja kumulative - e matur paraqitet si diferenca midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi për pasurinë financiare të njohur më parë në fitim ose humbje - është hequr nga kapitali dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi, të njohura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në instrumentat e kapitalit neto nuk kthehen në pasqyrën e të ardhurave.

3.12 Të arkëtueshmet tregtare

Të arkëtueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, më pak provizion për rënie në vlerë. Një dispozitë për rënie në vlerë të të arkëtueshmeve tregtare është krijuar, kur ka prova objektive se kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e paslyer sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë ose do të ndërmarrë riorganizim financiar, dhe mosplotësim të zotimeve ose shkelje ligjore në pagesat (më shumë se 30 ditë nga kalimi i afatit) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare kanë rënë në vlerë. Borxhet e mbetura vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditit.

3.13 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankat dhe investimet e tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitetet origjinale prej tre muajsh ose më pak.

3.14 Kompensimi i instrumenteve financiare

Asetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ka një të drejtë të ligjshme të zbatueshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për të vendosur mbi një bazë neto ose të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

3.15 Stoqet

Stoqet janë paraqitur në koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostoja përfshin shpenzimin e shkaktuar në blerjen e stokeve dhe sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Kostoja e inventarit të konsumuar është bazuar në formulën e mesatares së ponderuar.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.16 Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar dhe fitimet e mbajtura

(i) Kapitali i aksionarëve

Kapitali aksionar paraqet vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(ii) Fitimet e mbajtura

Fitimet e mbajtura përbëhen nga fitimet e pashpërndara në periudhat aktuale dhe të kaluara.

(iii) Dividendët

Dividendët njihen si detyrime në periudhat në të cilat janë deklaruar dhe janë miratuar nga aksionarët.

3.17 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare klasifikohen në pajtueshmëri me përmbajtjen e marrëveshjes kontraktuale. Të gjitha detyrimet financiare të kompanisë në datat e raportimit klasifikohen si detyrime të tjera financiare me kosto të amortizuar. Detyrimet financiare me kosto të amortizuar përbëhen nga llogaritë e pagueshme tregtare.

3.18 Të pagueshmet tregtare

Të pagueshmet tregtare janë detyrime për të paguar për mallrat ose shërbimet që janë pranuar në rrjedhën normale të biznesit nga furnizuesit. Llogaritë e pagueshme janë të klasifikuara si detyrime aktuale në qoftë se pagesa është brenda një viti ose më pak (në rast se më gjatë, në periudhën normale të shfrytëzimit të biznesit). Në të kundërtën, ato paraqiten si detyrime afatgjata. Të pagueshmet tregtare janë vlerësuar në vlerën e tyre reale dhe më pas maten me koston e amortizuar duke aplikuar metodën e normës efektive të interesit.

3.19 Përfitimet e të punësuarve

Pensionet e detyrueshme

Kompania, përgjatë rrjedhës normale të biznesit, kryen pagesa në emër të tij dhe në emër të të punësuarve të tij për të kontribuar në pensionin e detyrueshëm në pajtueshmëri me legjislacionin vendor. Kostot e pësura në emër të Kompanisë janë ngarkuar në fitim dhe humbje kur kanë ndodhur.

Përfitimet afatshkurtra

Obligimet e përfitimeve afatshkurtra të punonjësve janë matur në bazë jo-të skontueshme dhe janë shpenzuar pasi që shërbimi i ndërlidhur të jetë ofruar. Provizioni është njohur për shumën që pritet të paguhet sipas bonusit afatshkurtër në para nëse Kompania ka një obligim të tanishëm ligjor apo të tërthortë për të paguar shumën si rezultat i shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punonjësi dhe obligimi të mund të vlerësohet me besueshmëri.

3.20 Provizionet

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Kompania ka obligim të tanishëm apo të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të nevojitet një rrjedhje e parasë në të ardhmen për të shlyer obligimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar rrjedhat e pritshme të parasë në të ardhmen me normën përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë si dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.21 Njohja e të hyrave

Të hyrat u referohen të gjitha të hyrave të krijuara nga aktivitetet që biznesi zhvillon dhe përfshijnë vlerën nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve të kryera gjatë periudhës kontabël. Të hyrat nga shërbimet dhe shitja e mallrave njihen në momentin e kalimit të kontrollit të shërbimeve dhe mallrave tek klientët.

Të hyrat e kompanisë rrjedhin nga shërbimet dhe produktet e mëposhtme:

- Shërbimet e telefonisë mobile
- Shërbimet e telefonisë fikse
- Shërbime të internetit, tv, etj.

Të hyrat nga telefonia mobile

Të hyrat e telefonisë mobile nga kartat parapaguese me gërvishtje dhe Sim kartat njihen duke u bazuar në përdorim. Koha e pashfrytëzuar për bisedë është përfshirë në "Të hyrat e shtyra" në Pasqyrën e pozicionit financiar. Pas skadimit të kartave gërvishtëse me parapagim, koha e mbetur e pashfrytëzuar është e njohur si e hyrë.

Të hyrat nga komunikimi me kontratë (post paid) njihen duke u bazuar në kohën aktuale të gjeneruar të bisedës nga telefonuesi në periudhën aktuale.

Të hyrat nga roamingu ndërkombëtar (internacional roaming air time) njihen në bazë të minutave të shfrytëzuara në pajtueshmëri me raportet periodike financiare të ofruara nga ofruesi i shërbimit të rrjetit, Monaco Telecom International.

Të hyrat nga linja fikse

Të hyrat nga linja fikse njihen në bazë të minutave të ndërlidhura me periudhën aktuale.

Të hyrat nga shërbimi i internetit

Të hyrat nga shërbimet e internetit njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së abonimit të konsumatorit.

Të hyrat tjera

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur rreziqet e rëndësishme dhe shpërblimet e pronësisë i janë transferuar blerësit. Të hyrat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në proporcion me fazën e kompletimit të transaksionit në datën e pozicionit financiar.

3.22 Shpenzimet

Komisioni i detyruar ndaj Monaco Telecom International

Kostot e komisionit ndaj Monaco Telecom International njihen në bazë akruale kur kanë ndodhur.

Pagesat e qirasë operacionale

Pagesat e kryera nën qiranë operacionale janë njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Stimujt e pranuar të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

3.23 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi fondet e investuara në depozita bankare, fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve financiare të gatshme për shitje, dhe fitimet e valutës së huaj. Të hyrat e interesit janë njohur si parashikim aktual, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet e valutës së huaj, lëshimet e skontimit të provizioneve, nëse janë materiale, dhe humbjet e dëmtimit në vlerë të njohura në asetet financiare.

3 POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.24 Dhënia e dividendës

Dhënia e dividendës aksionarëve të Kompanisë është e njohur si detyrim në pasqyrat financiare në periudhën e miratuar nga aksionaret e Kompanisë.

3.25 Shpenzimi i tatimit mbi të ardhura

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhura përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi të ardhura është njohur në fitim dhe humbje përveç rasteve që ndërlidhen me artikujt e njohur direkt në ekuitet, ku në atë rast edhe tatimi është njohur në ekuitet.

Tatimi aktual i pagueshëm është kalkuluar dhe paguar në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-029 mbi të ardhurat e korporatave, që ka hyrë në fuqi nga 1 Shtatori 2015. Tatimi përfundimtar mbi fitimin në normën prej 10% bazohet mbi fitimin vjetor të prezantuar në pasqyrën e të ardhurave pas rregullimit të zërave që janë të pavlerësuar ose palejueshme. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet tatimore mund të barten brenda një periudhe prej shtatë vite, pas vitit në të cilin humbja tatimore ka ndodhur.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit të gjendjes, duke sjellë diferencë të përkohshme ndërmjet vlerave bartëse të aseteve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë në fuqi në datën e raportimit.

Aseti i tatimit të shtyrë njihet kur është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Asetet e tatimit të shtyrë janë rishikuar në secilën datë të raportimit dhe janë reduktuar ashtu që nuk është e mundur më tej që përfitimi i ndërlidhur tatimor të realizohet.

3.26 Zotimet dhe kontigjencat

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike brenda Kompanisë është e mundur. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka mundësi që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, një detyrim i pësuar në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

3.27 Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë ato palë, ku njëri nga palët është e kontrolluar nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palës tjetër.

3.28 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë mbi pozicionin e Kompanisë në datën e pasqyrave të pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënime kur kanë qenë materiale.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

4 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**4.1 Instrumentet financiare sipas kategorive**

Vlera bartëse e aseteve dhe detyrimeve financiare të kompanisë siç njihen në pasqyrën e pozicionit financiar, mund të kategorizohen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Asetet		
Interesi mbi ekuitet në entitetet ligjore të huaja	2	2
	<u>2</u>	<u>2</u>
Huatë dhe të arkëtueshmet		
Të arkëtueshmet tregtare	3,153	3,455
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	10,953	117
	<u>14,106</u>	<u>3,572</u>
	<u>14,108</u>	<u>3,574</u>
Detyrimet		
Detyrime të tjera në kosto të amortizuar		
Të pagueshmet tregtare	15,579	16,307
	<u>15,579</u>	<u>16,307</u>

4.2 Faktorët e riskut financiar

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë riskun e monedhës, riskun e vlerës së drejtë të interesit, riskun e normës së interesit nga rrjedhja e parasë dhe riskun e çmimeve), riskun e kreditimit dhe riskun e likuiditetit. Programi për menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut të Kompanisë përqendrohet tek pa-parashikueshmëria e tregjeve financiare dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Kompanisë.

Ky shënim paraqet informata rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të lartpërmendura, objektivat e Kompanisë, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimi i kapitalit nga ana e Kompanisë. Përshkrime të mëtejshme sasiore janë përfshirë në këto pasqyra financiare.

Menaxhmenti ka përgjegjësi të përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e kornizës së kompanisë për menaxhimin e rrezikut. Politikat e kompanisë për menaxhimin e riskut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Kompania, për të përcaktuar kufijtë dhe kontrollet përkatëse të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe përmbajtjen ndaj kufizimeve. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e rrezikut shqyrtohen në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet në treg dhe kushtet legjislative si dhe aktivitetet e Kompanisë.

4.3 Risku i kreditimit

Risku i kreditimit është risku i humbjes financiare të Kompanisë nëse konsumatori ose pala e kundërt ndaj një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e obligimeve kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet e Kompanisë nga konsumatori dhe investimet në depozita bankare.

Të arkëtueshmet tregtare

Kompania ka themeluar një kompensim të dëmit që përfaqëson vlerësimin e saj për humbjet e shkaktuara në lidhje me tregtinë dhe arkëtimet e tjera dhe investimet. Elementet kryesore të këtij kompensimi janë një komponentë kolektive e krijuar për klientët e ngjashëm në lidhje me humbjet që janë shkaktuar por ende nuk janë identifikuar. Kompensimi për humbjen kolektive është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për mjetet e ngjashme financiare.

4 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

4.3 Risku i kreditimit (vazhdim)

Investimet në depozita bankare

Kompania ka llogari të konsiderueshme rrjedhëse dhe investuese në të gjitha institucionet bankare në Kosovë.

Garancitë

Politika e Kompanisë është që të ofrojë garanci financiare vetëm me vendim të drejtorëve të autorizuar apo personelit kyç të menaxhmentit.

Procesi i menaxhimit të riskut të kreditimit nga aktivitetet operative përfshin masa parandaluese, siç janë kontrollimi i kreditibilitetit dhe parandalimit, masat korrigjuese gjatë marrëdhënies juridike, për shembull aktivitetet e rikujtimit për respektimin e obligimeve në garancinë bankare, aktivitetet e shkyçjeve, bashkëpunimi me agjencitë e mbledhjes dhe grumbullimit pas marrëdhënies ligjore siç janë procesi gjyqësor, procedura gjyqësore, përfshirja e njësisë së ekzekutivit dhe faktorizimit. Pagesat e mbetura janë përcjellë me një procedurë të përshkallëzuar të borxhit në bazë të llojit të konsumatorit, klasës së kreditit dhe shumës së borxhit.

Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është përfaqësuar nga shuma bartëse e çdo aseti financiar në pasqyrën e gjendjes financiare të përmbledhur më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Kategoritë e aseteve financiare - shumat ngritëse:		
Interesi mbi ekuitet në entitetet ligjore të huaja	2	2
Të arkëtueshmet tregtare	3,153	3,455
Para dhe ekuivalentet e parasë	10,953	117
	<u>14,108</u>	<u>3,574</u>

Risku i kreditit për paranë dhe ekuivalentet e parasë dhe depozitat konsiderohen të papërfillshme, pasi që palët homologe janë banka me reputacion me cilësi të lartë të normave të kreditit të jashtëm.

4 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

4.4 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit definohet si risku që Kompania nuk mund të jetë në gjendje ta zgjidhë, ose të përmbushë detyrimet e saj në kohë.

Politika e Kompanisë është që të mbajë para dhe ekuivalente të parasë, të mjaftueshme për të përmbushur angazhimet e saj në të ardhmen e parashikueshme. Sektori i financave po përgatit parashikimin e rrjedhës së parasë për kërkesat e likuiditetit, për të siguruar se ka para të mjaftueshme për të plotësuar nevojat operationale në çdo kohë. Parashikimi merr parasysh planet e Kompanisë për financimin e borxheve dhe pajtueshmërinë me objektivat e përpjesëtimit të pasqyrave të pozicionit financiar. Çdo para e gatshme (kesh) tepricë e mbajtur nga Kompania mbi bilancin e kërkuar për nevojat e kapitalit të punës, zakonisht është depozituar në bankat komerciale.

4.5 Risku i tregut

Risku i tregut është rreziku se ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si kursi i këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e ekuitetit do të ndikojnë në të hyrat e Kompanisë ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektiva e menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj këtij rreziku përbrenda parametrave të pranuar, duke e optimalizuar kthimin.

Risku i këmbimit të jashtëm

Si një e tërë, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj ndonjë rreziku të monedhës, sepse:

- të hyrat fitohen në Euro
- blerjet e aseteve kryesore dhe materialeve të përdorura në aktivitetet e investimeve të Kompanisë janë nominuar në Euro
- pasuritë financiare nominohen në Euro.

Risku i çmimit

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të letrave me vlerë të kapitalit të çmimeve për shkak të investimeve të mbajtura, përveç aseteve financiare të gatshme për shitje, të shpalosura në shënimin 8, të cilat mund të preken nga ndryshoret e rrezikut, të tilla siç janë çmimet e bursës.

4 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**4.5 Risku i tregut (vazhdim)***Rrjedhja e parasë së gatshme dhe rreziku i normës së interesit të vlerës së drejtë*

Norma e riskut të interesit është rreziku se vlera e drejtë e rrjedhave të ardhshme të parave të gatshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i kompanisë ndaj riskut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me investimet e kompanisë në depozitat bankare.

Llogaritë e depozitave bankare të TK-së fitojnë interes me përqindje të caktuar komerciale në datën e kontratës përkatëse dhe janë të maturura sipas datave fikse. Kompania nuk ka huazime me kamatë në 2021 dhe në 2020.

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Kompanisë ndaj riskut të normës së interesit.

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Asetet		
<u>Që nuk bartin interes:</u>		
Pasuritë financiare të disponueshme për shitje	2	2
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	3,153	3,455
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	10,953	117
	<u>14,108</u>	<u>3,574</u>
 <u>Me norma fikse të interesit:</u>		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë		-
		-
 Gjithsej asetet	<u>14,108</u>	<u>3,574</u>
 Detyrimet		
<u>Që nuk bartin interes:</u>		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	15,579	16,307
Gjithsej detyrimet	<u>15,579</u>	<u>16,307</u>

4.6 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Politika e menaxhimit është të mbajë një bazë të fortë kapitale në mënyrë që të ruajë besimin e tregut dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen.

Për shkak të kufizimeve të jashtme të vendosura nga mjedisi (p.sh. pamundësia që të vendosen depozitat jashtë vendit, proceset e gjata të prokurimit, etj.) menaxhmenti i kompanisë nuk mund të zbatojë një menaxhim efikas të kapitalit të veçantë në ekonomitë e liberalizuara.

Nuk ka pasur ndryshime në qasjen e Kompanisë në menaxhimin e kapitalit gjatë vitit.

Kompania nuk është subjekt i kërkesave kapitale të imponuara në mënyrë kontraktuale apo ligjore.

4.7 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë paraqet shumën me të cilën një pasuri mund të zëvendësohet ose një detyrim i vendosur në bazë të gjerë. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas profilit të pasurisë dhe bazës së detyrimit.

4.7.1 Instrumentet financiare të prezantuara në vlerë të drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e gjendjes financiare në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë janë prezantuar në tabelën e ardhshme. Kjo hierarki grupon mjetet dhe detyrimet financiare në tri nivele, që janë të bazuara mbi rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia sipas vlerës reale përcaktohet si vijon:

4 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**4.7.1 Instrumentet financiare të paraqitura në vlerë të drejtë (vazhdim)**

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për mjetet identike ose detyrimet;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera hyrëse, përveç çmimet e cituara, të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë në dispozicion për vrojtimin e asetit ose detyrimit, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmimet), ose në mënyrë indirekte (d.m.th. të përcaktuara nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi asetin ose detyrimin, që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për hulumtimin e tregut.

Asetet financiare, që janë të regjistruara në përputhje me vlerat e tyre të drejta në Pasqyrën e pozicionit financiar, janë të grupuara sipas shkallës së hierarkisë të vlerës së drejtë, si vijon

Asetet	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Asetet financiare të gatshme për shitje më 31 Dhjetor 2021	-	2		2
Asetet financiare të gatshme për shitje, më 31 Dhjetor 2020	-	2		2

Asetet financiare të disponueshme për shitje përmbajnë pjesëmarrjen në kapitalin e subjekteve të huaja ligjore.

4.7.2 Instrumentet financiare që nuk janë të paraqitura si vlerë e drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat e drejta të llogaritjes së aseteve dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në bilancin e gjendjes në vlerën e drejtë të tyre.

Asetet	31 Dhjetor		Vlera bartëse	
	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	10,953	117	10,953	117
Të arkëtueshme tregtare	3,153	3,455	3,153	3,455
Gjithsej asetet	14,106	3,572	14,106	3,572
Detyrimet				
Të pagueshme tregtare	15,579	16,307	15,579	16,307
Gjithsej detyrimet	15,579	16,307	15,579	16,307

Të arkëtueshmet tregtare

Të arkëtueshmet tregtare mbahen me koston e amortizuar, minus dispozita për zhvlerësim. Për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër, vlera e tyre e drejtë korrespondon me vlerën e mbartur.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare që përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat llogaritëse të tyre me përcaktim dhe për shkak të maturisë së tyre më pak se 3 muaj.

Të pagueshmet tregtare

Vlera bartëse e të pagueshmeve tregtare është e përafërt me vlerën e tyre të drejtë, për shkak të maturitetit afatshkurtër.

5 VLERËSIMET DHE GJYKIMET KONTABËL

Menaxhmenti ka diskutuar me Komitetin e Auditimit, Financave të Sigurimeve, me një Komitet Këshillëdhënës për Bordin e Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.a, mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shpalosjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit, si dhe vlerësimin dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë

Rikuperimi i llogarive dhe depozitave bankare

Deri në fund të vitit 2005, Banka Kreditore e Prishtinës, me të cilën Kompania kishte depozitat më 31 Dhjetor 2005, hyri në provueshmëri pas tërheqjes së licencës nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës më 13 mars 2006. Është bërë provizion për pasqyrat financiare për këtë vit dhe vitet paraprake për bilanci më 31 Dhjetor 2021 në vlerë prej 11,689 (2020:11,691) në, pasi që një pasiguri e rëndësishme ekziston në rikuperimin e bilanceve me këtë bankë. Në vitin 2021 kompania ka kompensuar 2 mijë dhe i ka njohur si të ardhura në përputhje me rrethanat (2020: s'ka).

Pasi që ende nuk është e mundur që të përcaktohet rezultati i procesit të likuidimit dhe shuma e depozitave të garantuara nga BPK, ekzistojnë pasiguritë e konsiderueshme në rikuperimin e bilanceve me këtë bankë. Prandaj, është siguruar një humbje e shkaktuar nga 100% të shumave të mbajtura me bankën. Nëse ka asete të mjaftueshme të likuidimit për të mbuluar pretendimet e kreditorëve, të ardhurat do të njihen në periudhat e ardhshme deri në shumën e rikuperuar.

Jetëgjatësia e pasurive

Përcaktimi i jetëgjatësisë së aseteve është bazuar në përvojën e kaluar me asete të ngjashme, si në faktorë të gjerë ekonomik ose industrial. Përshtatshmëria e jetëgjatësisë së vlerësuar është shqyrtuar çdo vit, ose sa herë që ka pasur një tregues të ndryshimeve të rëndësishme në supozimet përkatëse. Ne besojmë se vlerësimi kontabël në lidhje me përcaktimin e jetëgjatësisë së aseteve është një vlerësim i rëndësishëm i kontabilitetit pasi që përfshin vlerësimet në lidhje me zhvillimin teknologjik në një industri inovative. Pas kësaj kompania kishte bërë një vlerësim që jetëgjatësia e aseteve duhet të mbetet e njëjtë si vitin paraprak.

Stoqet

Stoqet paraqiten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjatë përcaktimit të vlerës neto të realizueshme, janë marrë dëshmitë më objektive / të dhënat e disponueshme në bërjen e vlerësimeve.

Rikuperimi i llogarive të arkëtueshme

Llogaritja e zhvlerësimit për llogaritë e dyshimta është bërë duke u bazuar në humbjet e vlerësuar që rrjedhin nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e kërkuara. Ne e bazojmë vlerësimin tonë në vjetrimin e bilancit të llogarive të arkëtueshme dhe përvojën e kaluar të zhvlerësimit, vlefshmërinë e kredisë të konsumatorëve, dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së konsumatorëve tanë, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së humbjes nga shlyerja për llogaritë e dyshimta. Këto përfshijnë vlerësime në lidhje me sjelljen e konsumatorëve në të ardhmen dhe që rezultojnë me grumbullimet e parasë së gatshme në të ardhmen. Nëse gjendja financiare e klientëve tanë do të përkeqësohet, shlyerjet e tanishme të të arkëtueshmeve ekzistuese mund të jenë më të larta se sa pritej dhe mund të tejkalojnë nivelin e humbjeve në vlerë, të njohura deri tani.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

6 PASURITË E PATRUPEZUARA

	Programet kompjuterike	Licencat	Gjithsej
<u>Kostoja</u>			
Gjendja më 1 janar 2020	31,870	24,886	56,756
Shlyerjet	(117)	-	(117)
Transferet (Shënimi 7)	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	31,753	24,886	56,639
Gjendja më 1 janar 2021	31,753	24,886	56,639
Shlyerje	(123)	-	(123)
Transferet (Shënimi 7)	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	31,630	24,886	56,516
<u>Amortizimi i akumuluar</u>			
Gjendja më 1 janar 2020	(25,496)	(12,554)	(38,050)
Shpenzimet për periudhën	(3,036)	(642)	(3,678)
Shlyerjet	117	-	117
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(28,415)	(13,196)	(41,612)
Gjendja më 1 janar 2021	(28,415)	(13,196)	(41,612)
Shpenzimet për periudhën	(2,502)	(611)	(3,113)
Shlyerjet	123	-	123
Gjendja më 31 dhjetor 2021	(30,794)	(13,808)	(44,602)
<u>Vlera bartëse neto</u>			
Më 31 dhjetor 2020	3,338	11,690	15,027
Më 31 dhjetor 2021	836	11,078	11,914

Programet kompjuterike ndërlidhen me koston e sistemit të faturimit dhe platformën e shërbimit të internetit.

Në vitin 2004 dy licenca janë dhënë për 15 vite për të operuar me telekomunikacion përbrenda Kosovës, që përbëhen nga një licencë e telefonisë mobile prej 6,500 mijë Euro dhe një të telefonisë fikse prej 2,900 mijë Euro.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

7 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka dhe ndërtesat	Linjat e rrjetit	Makineria dhe pajisjet	E drejta e shfrytëzimit	Avanset për dhe Investimet në vijim	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	707	81,433	118,320	22,196	531	223,187
Shtesat	-	-	-	-	560	560
Shlyerjet	(7)	(40)	(2,146)	(634)	-	(2,827)
Transferet	-	275	340	-	(615)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	700	81,668	116,514	21,562	476	220,920
Gjendja më 1 janar 2021	700	81,668	116,514	21,562	476	220,920
Shtesat	-	-	-	343	560	903
Shlyerjet	(4)	(14)	(1,844)	-	-	(1,862)
Transferet	-	298	461	-	(759)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	696	81,951	115,131	21,905	277	219,960
<u>Zhvlerësimi i akumuluar:</u>						
Gjendja më 1 janar 2020	(411)	(58,763)	(104,525)	(4,937)	-	(168,637)
Shpenzimi për periudhën	(38)	(3,747)	(5,233)	(4,725)	-	(13,742)
Shlyerje	7	40	2,146	-	-	2,193
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(442)	(62,470)	(107,612)	(9,662)	-	(180,186)
Gjendja më 1 janar 2021	(442)	(62,470)	(107,612)	(9,662)	-	(180,186)
Shpenzimi për periudhën	(37)	(3,322)	(3,368)	(4,570)	-	(11,297)
Shlyerje	4	14	1,844	-	-	1,862
Gjendja më 31 dhjetor 2021	(475)	(65,778)	(109,136)	(14,232)	-	(189,621)
<u>Vlera bartëse neto</u>						
Më 31 dhjetor 2020	258	19,198	8,902	11,900	476	40,734
Më 31 dhjetor 2021	221	16,173	5,995	7,673	277	30,339

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

7 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM)

Transferimet

Gjatë periudhës 01 Janar -31 Dhjetor 2021, ka pasur transferime nga investimet në vijim në asetet e trupëzuara 759 dhe të patrupëzuara nuk ka (shih shënimin 6,7).

Shlyerja e pronës, implantëve dhe pajisjeve

Gjatë periudhës 01 Janar - 31 Dhjetor 2021 Kompania ka shlyer 1,862 mijë euro artikuj të implantëve dhe pajisjeve, ato patën efekt në vlerën e pajisjeve mirpo patën efekt në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2021 vetëm për 30 mijë euro sepse pjesa tjetër ishin plotësisht të zhvlerësuara në nuk patën vlerë neto (2020: nuk kishin vlerë neto). Shlyerja tek pasurite e patrupëzuara ishte 123 mijë euro, patën efekt në vlerën e të pasurive të patrupëzuarave dhe nuk patën efekt në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2021, sepse nuk kishin vlerë të mbetur.

Humbjet nga dëmtimi në vlerë dhe rimarrja e mëvonshme

Kompania vazhdimisht merr në konsideratë përparimet teknologjike mbi asetet fikse, duke rishikuar edhe funksionalitetin e qëndrueshmërinë e tyre në infrastrukturën ekzistuese. Në qoftë se ka ndonjë pajisje të dëmtuar apo të vjetruar, atëherë kryhet testi i dëmtimit në vlerë dhe pajisja ose humb vlerë ose del nga përdorimi.

Asetet e kolateralizuara

Prona, implantet apo pajisjet nuk janë dhënë si kolateral për ndonjë huazim.

Pronësia

Çështjet e pronësisë ekzistojnë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillim të administrimit të OKB-së në Kosovë në vitin 1999. Kjo paraqet një detyrim kontingjent të PTK-së që për momentin nuk është e kuantifikueshme. Zgjidhja e titullit është një element i institucionalizimit të statusit final të Kosovës, ku PTK-ja nuk është palë.

E drejta e shfrytëzimit të aseteve

Në përputhje me kërkesat e SNRF 16, kompania në datën e raportimit, ka njohur një të drejtë përdorimi që përfaqëson të drejtën e tij për të përdorur aktivin themelor të marrë me qira dhe një detyrim të qirasë që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa të qirasë. Kompania si qiramarrës, ka matur aktivet e së drejtës së përdorimit në mënyrë të ngjashme me aktivet e tjera jo-financiare (siç janë prona, uzina dhe pajisjet) dhe detyrimet e qirasë në mënyrë të ngjashme me detyrimet e tjera financiare. Si pasojë, si qiramarrës për të njohur zhvlerësimin e aktivit të së drejtës së përdorimit dhe interesit mbi detyrimin e qirasë, dhe gjithashtu një pjesë të interesit i kemi paraqitur në pasqyrën e rrjedhjes së fluksit të parave të gatshme. Pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga qiraja fillimisht u matën mbi bazën e vlerës aktuale. Matja përfshin pagesa që duhen bërë në periudha e caktuara, por në si qiramarrës duhet të vlerësojmë nëse ekziston një siguri e arsyeshme të ushtrijmë një mundësi për të zgatur qiranë.

Çështjet tjera

Nuk ka asete të siguruara nën kushtet e qirasë financiare.

Më 31 Dhjetor 2021 pasuritë plotësisht të zhvlerësuara janë 172,012 mijë euro në kosto (Më 31 Dhjetor 2020: 155,052).

8 PASURITË FINANCIARE TË DISPONUESHME PËR SHITJE

Më 31 Dhjetor 2021, asetet financiare në dispozicion për shitje nuk kanë ndryshur nga data e raportimit të fundit, janë në vlerë prej 2,130 Euro, (2020: 2,130 Euro) dhe kryesisht përbëhen nga investimi në Mobile 4 AL Sh.a, Shqipëri

9 PASURITË DHE DETYRIMET E TATIMIT TË SHTYRË

Njohja e Pasurive të taksave të shtyra dhe detyrimeve

Norma e tatimit e aplikueshme nga Kompania paraqet normën e detyrueshme të tatimit të korporatës që është 10%.

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Detyrimet e tatimit të shtyrë në fillim të vitit	-	-
Ndryshimi i njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-
Detyrimet e tatimit të shtyrë	-	-
Pasuritë e tatimit të shtyrë më 1 janar	1,410	1,168
Ndryshimi i njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (Shënim 23)	(176)	242
Detyrimet e tatimit të shtyrë	1,234	1,410

Detyrimet e tatimit të shtyrë të njohur në Pasqyrën e pozicionit financiar ndërlidhen me diferencat e përkohshme ndërmjet kontabilitetit dhe tatimeve të pronës, implanteve dhe pajisjeve.

Pasuritë e panjohura të tatimit të shtyrë

Asetet e tatimit të shtyrë nuk janë njohur në lidhje me dëmtimin në vlerë të të arkëtueshmeve tregtare sepse nuk ka gjasa në këtë fazë që asetet e tilla do të përdoren në periudhat e ardhshme.

10 STOQET

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Kabllot dhe materialet e mirëmbajtjes	2,393	2,591
Kartelat SIM dhe kartelat gërvishëse	259	218
Stoqet në konsignacion	22	35
Stoqet tjea	114	105
TOTALI	2,788	2,949

11 SHPENZIMET E PARAPAGUARA DHE TË ARKËTUESHMET E TJERA

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Qiraja	367	765
Tatimi	19	-
Shpenzimet e shtyra	342	33
Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera	121	258
TOTALI	849	1,056

Kërkesat kontestuese kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat për tatimin e mbajtur në burim për kodin shtetëror, kërkesë që është në proces gjyqësor me ATK-në.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

12 TË ARKËTUESHMET TREGTARE

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Linjat fikse - personat fizik	3,680	3,570
Linjat fikse - kompanitë	4,218	5,130
Rrjeti i telefonisë mobile	8,687	8,925
Shërbime shtesë -kodi shtetëror, VAS, huazim linjave)	514	654
Roaming - Monaco Telecom International	179	290
Thirrjet në ardhje - Monaco Telecom Int.	24	36
Llogari tjera të arkëtueshme	435	111
TOTALI	17,737	18,716
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta	(14,584)	(15,261)
TOTALI	3,153	3,455

Provizioni për dëmtim në vlerë

Lëvizja në dëmtimin në vlerë për borxhet e dyshimta është përmbledhur si më poshtë:

	Linja fikse	Linja mobile	Gjithsej
Gjendja hapëse më 1 Janar 2020	7,354	9,370	16,724
Rritja/Zvogëlimi (Shënim 22)	(30)	209	179
Shlyerja e provizioneve	-	(1,642)	(1,642)
Gjendja mbyllëse më 31 Dhjetor 2020	7,324	7,937	15,261
Gjendja hapëse më 1 janar 2021	7,324	7,937	15,261
Rritja (Shënim 22)	(500)	(177)	(677)
Gjendja mbyllëse më 31 Dhjetor 2021	6,824	7,760	14,584

Më 31 Dhjetor 2021, Kompania ka vlerësuar grumbullimin e të arkëtueshmeve, në bazë të të cilave ajo ka zvogluar provizionet dhe ka njohur të ardhur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në shumën 677 mijë euro, në vitin 2020 ka njohur humbje në vlerë si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në shumën 179 mijë euro.

Gjatë vitit 2021 kompania nuk ka bërë shlyerje të provizioneve (2020: 1,642 mijë euro).

13 PARAJA DHE EKVIVALENTET E SAJ

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Llogaritë rrjedhëse bankare me bankat lokale	10,938	99
Paraja në dorë	15	18
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	10,953	117

Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, kompania nuk ka mjete të kufizuara për letër kredite.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

14 KAPITALI AKSIONAR, REZERVAT DHE FITIMET E MBAJTURA

Kapitali aksionar

Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/L-087), dhe bazuar në nenin 3 të këtij Ligji, ndërmarrjet publike duke përfshirë PTK Sh.a, janë deklaruar si pronë e Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka autoritetin ekskluziv për të ushtruar të drejtat e aksionarëve mbi NP-të.

Më 13 tetor 2009, statusi i kompanisë është ndryshuar dhe plotësuar: kapitali themelor i lëshuar përmban 5 milionë aksione Euro (pesë milionë), i përbërë nga pesë milionë aksione të zakonshme me vlerë nominale nga 1 (një) Euro për secilën.

Më 1 Gusht 2012, 525 mijë aksione janë transferuar te Posta e Kosovës, kështu që kapitali aksionar me 31 dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 përbëhet nga 4,475 mijë aksione, përkatësisht 4,475 mijë euro. Të gjitha aksionet janë lëshuar në emër të Republikës së Kosovës.

Më 22 korrik 2015 aksionarët - Qeveria e Republikës së Kosovës i ka miratuar Bordit të Drejtorëve, kërkesën për të ndryshuar emrin ligjor të kompanisë nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a në Telekom i Kosovës Sh.a. Entiteti i ri ligjor, është përditësuar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës më 12 gusht 2015.

Komponentet tjera të kapitalit

Rezervat janë krijuar gjatë vitit 2009 me bashkimin e dy kompanive PTK Holding dhe PTK Sh.a., me vendim të Qeverisë për pjesën e alokimit të kapitalit të konsoliduar në rezerva në shumën prej 55,000 mijë Euro.

Dividendët e deklaruar

Gjatë periudhës 01 janar - 31 Dhjetor 2021, kompania nuk ka deklaruar dividendë. Shuma prej 15,000 mijë Euro është regjistruar si e pagueshme në pasqyrën e pozicionit financiar nga viti 2015, mirëpo në fund të vitit 2021 me vendim të aksionarit është anuluar dividendë e deklaruar.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

15 PROVIZIONET, AKRUALET DHE TE PAGUESHMET TJERA

15.1 PROVIZIONET

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Provizionet për vendimet e gjykatave - Dardafon.net	22,274	17,281
Provizionet për vendimet e gjykatave - tjera	3,029	5,069
TOTALI	25,303	22,350

Provizionet për vendimet e gjykatave - Dardafon.net përfshinë:

1. Provizioni që lidhet me rastin e vendimit final të Arbitrazhit ndërkombëtar sipas rregullave të ICC e cila mban numrin 20990/MHM te vitit 2016 vlera e mbetur në shumë rreth 8.8 milion €, në Mars të vitit 2022 Gjykata e Apelit e ka kthyer rastin në rigjykim.
2. Provizioni që lidhet me rastin e vendimit final të Arbitrazhit ndërkombëtar sipas rregullave të ICC e cila mban numrin 24841/MHM/HBH te datës 18/02/2022 në vlerë prej 13,446 milion € sipas detajeve me poshtë. Telekom do të ndjek të gjitha procedurat ligjore për të kundërshtuar këtë vendim të padrejtë.

	Euro
Vendimi i arbitrazhi II NO. 24841/MHM/HBH	10,270
Vendimit Final (pika 4 dhe 6)	1799
Vendimit Final Interesi 8% (Pika 7)	1291
Vendimit Final (Pika 10)	106
Vendimit Final (Pika 11) 117,000.00USD (Konvertimi 22/03/2022)	13,466
Borxhi i mbetur	

15.2 TE PAGUESHMET TJERA DHE AKRUALET

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Akrualët për shpenzimet e komisionit	9,792	10,799
Kontributet pensionale në TRUST	1,283	194
Tatimi i pagueshëm në të ardhura personale	1,205	127
Pagat e pagueshme	807	896
Tatimi i mbajtur në burim	602	63
Tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tjera të pagueshme	8,829	3,748
Të pagueshmet tjera	22	31
TOTALI	22,542	15,858

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

16 LLOGARITE E PAGUESHME TREGTARE

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Posta E Kosovës Sh.A	1,510	1,889
Infrakos	720	563
Qazim Gashi Pr.	363	-
Paykos Sh.A	377	246
Termokos	148	171
Alcatel Lucent Cit Fr	112	122
Tring Tv	127	316
Kek - Prishtinë	112	163
Albtelekom	93	585
Kompania E Sigurimeve Eurosig	59	418
Mana SH.P.K	53	53
Furnitorë të tjerë	11,905	11,781
TOTALI	15,579	16,307

16.1 DETYRIMET - E drejta e shfrytëzimit

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Objektet afariste	3,489	7,127
Persona juridik dhe fizik-qiratë për BTS	4,039	4,578
Qiratë tjera	145	195
	7,673	11,900

Sipas SNRF 16, e drejta e përdorimit të pasurisë në shumën prej 11,900 (shënimi 7 prona, implantet dhe paisjet) është testuar rënia në vlerë në përputhje me SNK 36 rënia në vlerë e aseteve për vitin 2021 4,570 mijë euro (2020:4,726). Kontratat e reja të qirave për këtë periudhë kanë një vlerë prej 343 mijë euro. Për qiratë afatshkurtra (afati i lizingut prej 12 muajsh ose më pak), kompania ka zgjedhë të njohë shpenzim qiraje në bazë të lizingut të drejtë siç lejohet nga SNRF 16.

17 TE HYRAT E SHTYRA

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Parapagimi i telefonisë mobile (top up dhe kartat gërvishtëse)	3,566	3,887
Tarifat e telefonisë mobile të faturuara në avancë	108	127
Donacionet nga Qeveria	2,351	285
TOTALI	6,025	4,299

Të hyrat e shtyra kanë të bëjnë me pjesën e papërdorur në fundvit të parapagimeve dhe kartave gërvishtëse të shitura konsumatorëve të telefonisë mobile gjatë vitit. Për periudhën që raportojmë është përlogaritur krediti, i pashfrytëzuar deri me datën 31 dhjetor 2021.

Te hyrat e shtyra të klasifikuara si donacione prej 2,351 mijë janë projektet e financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës ku prej tyre 1,887 mijë janë pjesë e donacionit të fund vitit prej 10 milion.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

18 TË HYRAT

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Të hyrat e shërbimeve të telefonisë mobile	41,705	36,266
Të hyrat e linjës fikse	7,279	6,910
Të hyrat e shërbimeve të internetit	620	655
Të hyrat nga kabinat e telefonave publike	319	312
Të hyrat nga telefonat zyrtarë	87	633
Të hyrat tjera	531	6,382
TOTALI	50,541	51,158

19 TË HYRAT TJERA

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Të ardhurat nga lirimimi e provizionimi, nga dëmtimi në vlerë për depozitat afatshkurtra (Shënimi 5)	2	-
Donacionet nga Qeveria	8,155	-
Të hyra tjera	205	258
TOTALI	8,362	258

20 SHPENZIMET OPERATIVE

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Kosto e rrjetit të telefonisë mobile	2,030	2,019
Zbritja e shitjeve	136	(130)
Komisionet për shitje përmes Postës së Kosovës	1,261	1,341
Shërbimet publike	1,342	1,324
Komisionet për shitjet përmes Paykos	1,943	2,036
Kostoja direkte e produkteve të shitura	1,978	1,816
Komisioni për shërbime telefonike të ofruara nga MTI-ja	188	213
Kostot e karburantit	147	98
Kostoja për trafik ndërkombëtar/linja me qira	2,765	987
Kostoja e materialit për mirëmbajtje	633	1,784
Kostoja për IP interkomunikim	55	62
Lidhje satelitore dhe pajisjet	12	18
TOTALI	12,490	11,568

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

21 SHPENZIMET E STAFIT

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Pagat	22,310	24,846
Kontributet pensionale	1,249	1,381
TOTALI	23,559	26,227

22 SHPENZIME TJERA OPERATIVE

	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2021	Periudha përfunduar 31 Dhjetor 2020
Qiraja	1,869	1,552
Sigurimi dhe mirëmbajtja	701	506
Marketingu	92	198
Tarifat e licencës, detyrimet doganore dhe tatimet	2,016	1,983
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta dhe	-	(1,463)
Provizionet për obligimet kontigjente	10,748	6,408
Shpenzimet e trajnimit dhe udhëtimit	5	17
Shpenzimet e zyrës dhe ato administrative	618	711
Shpenzimet e mjeteve motorike	137	139
Shërbimet për konsulentë	192	791
Tjera	2,159	3,426
TOTALI	18,537	14,268

- Shpenzimet tjera përfshijnë tarifën për shërbimet bankare, kostot e veturave, humbjet nga shlyerjet, etj.

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

23. SHPENZIMET E TATIMIT MBI TË ARDHURAT (VAZHDIM)

Më poshtë është paraqitur harmonizimi i të arkëtueshmeve të tatimit të korporatës në datën e pasqyrave të pozicionit financiar:

	Viti i përfundur më 31 dhjetor 2021	Viti i përfundur më 31 dhjetor 2020
Tatimi mbi të ardhurat i arkëtueshëm/ (i pagueshëm) më 1 janar	5	5
I transferuar në parapagime	-	-
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	-	-
Pagesat e tatimit mbi të ardhurat të bëra gjatë vitit	-	-
Tatimi mbi të ardhurat i arkëtueshëm/ (i pagueshëm) më 31 dhjetor	5	5

24. PALËT E NDËRLIDHURA

Në rrjedhën normale të biznesit, Telekom i Kosovës Sh.a. kryen transaksione gjatë periudhave financiare raportuese me konsumatorët si entitetet qeveritare dhe personat të cilët janë të ndërlidhur me entitetet qeveritare. Kompania ka gjithashtu marrëdhënie si palë të ndërlidhura me drejtorët dhe zyrtarët ekzekutiv të saj. Transaksionet monetare me palët e ndërlidhura dhe drejtorët dhe zyrtarët ekzekutiv të saj kanë qenë vetëm në lidhje me pagesat e mëposhtme:

	Viti i përfundur më 31 Dhjetor 2021	Viti i përfundur më 31 Dhjetor 2020
Kompensimet për zyrtarët ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv	122	91
TOTALI	122	91

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021
(të gjitha shumat janë në mijëra Euro, përveç nëse ceket ndryshe)

25. KONTIGJENTET

Procedurat ligjore

Më 31 dhjetor 2021, procedurat ligjore të ngritura kundër Kompanisë arrijnë deri në 82,278 mijë Euro. Në datën e raportimit, përveç atyre të paraqitura në Shënimin 15.1 më lart, nuk ka provizionime ose humbje potenciale të regjistruara, në lidhje me procedurat ligjore. Menaxhmenti i kompanisë, rregullisht analizon rrezikun potencial që del nga humbjet në lidhje me procedurat ligjore, së bashku me procedurat dhe të arkëtueshmet e mundshme me synim kundër kompanisë, e të cilat mund të lindin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk ka detyrime materiale shtesë që kanë të ngjarë të rezultojnë.

Pronësia mbi pronën, implantet dhe pajisjet

Shënimi 5, prona, implantet dhe pajisjet, i referohet çështjeve të pronësisë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillimin e Administratës së OKB-së në Kosovë. Kjo paraqet një detyrim kontingjent për TK-në i cili nuk është e mundur të kuantifikohet në këtë kohë.

Garancitë në favor të palëve të treta

Më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 nuk ka garancione të lëshuara në favor të palëve të treta.

Zotimet kapitale

Nuk ka zotime madhore kapitale të kontraktuara në datën e bilancit të gjendjes të cilat tashmë nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

26. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e koronavirusit (COVID-19) si pandemi. Si rezultat, janë krijuar paqartësi ekonomike të cilat ka të ngjarë të ndikojnë negativisht në të ardhurat neto dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve. Aktualisht, Kompania nuk është në gjendje të vlerësojë efektet e mundshme të kësaj pandemie në pasqyrat tona financiare. Kompania konsideron që kjo është një ngjarje jo-rregulluese pas datës së bilancit të gjendjes. Për më shume referohuni në Shënimin 3.5, Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.

Nuk ka ngjarje të tjera që janë materialisht të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin shpalosje në pasqyrat financiare të Kompanisë.